



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.48

28 prill

2011

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 413
datë 7.4.2011

Për ratifikimin e “Marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e programit “Infrastruktura bashkiake I”.....

2027

Ligj nr.10 414
datë 7.4.2011

Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e programit “Infrastruktura bashkiake I”, sistemi i furnizimit me ujë dhe kanalizime për qytetet Lezhë, Gjirokastër, Sarandë dhe Fier”.....

2051

LIGJ
Nr.10 413, datë 7.4.2011

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCEVE, DHE KfW FRANKFURT AM MAIN PËR FINANCIMIN E PROGRAMIT “INFRASTRUKTURA BASHKIAKE I””

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e programit “Infrastruktura bashkiake I””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6979, datë 20.4.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE FINANCIMI
NDËRMJET KfW, FRANKFURT AM MAIN (KfW) DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCEVE (PËRFITUESI) PËR 4,621,500 EURO
- INFRASTRUKTURA BASHKIAKE I

Mbi bazën e marrëveshjes së kontributit të datës 11 gusht 2009, ndërmjet Komisionit Euroian, Bankës së Zhvillimit të Këshillit të Europës dhe KfW-së (marrëveshja e kontributit), përfituesi dhe KfW-ja lidhin marrëveshjen e mëposhtme të financimit.

Neni 1

Shuma dhe qëllimi i kontributit financiar

1.1 KfW-ja i jep përfituesit një kontribut financiar që nuk kalon 4,621,500 euro.

Ky kontribut financiar nuk është i shlyeshëm, përveç kur parashikohet ndryshe në nenin 3.2.

1.2 Përfituesi do ta përdorë kontributin financiar vetëm për zbatimin e programit të infrastrukturës bashkiake I në vendndodhjet Gjirokastër dhe Fier (programi), dhe kryesisht për të financuar koston e normës së shkëmbimit. Përfituesi, i përfaqësuar nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit që vepron si njësi e zbatimit të programit (njësia e zbatimit të programit), shoqëritë e ujësjellësit UK Lezhë, UK Gjirokastër, UK Sarandë dhe UK Fier (së bashku agjencitë e zbatimit të projektit, secila një agjenci e zbatimit të projektit) dhe KfW-ja do të përcaktojë hollësitë e programit, si dhe mallrat dhe shërbimet që financohen nga huaja në një marrëveshje të veçantë, që duhet të miratohet nga Huadhënësi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave.

1.3 Tatimet dhe detyrimet e tjera publike mbulohen nga Përfituesi dhe detyrimet e importit nuk financohen nga kontributi financiar.

Neni 2 **Disbursimi**

2.1 KfW-ja e disburson kontributin financiar në pajtim me përparimin e programit dhe me kërkesë të Përfituesit. Me marrëveshje të veçantë, përfituesi, i përfaqësuar nga njësia e zbatimit të programit, dhe KfW-ja përcaktojnë procedurën e disbursimit, veçanërisht prova që provojnë se fondet e kërkuara përdoren për qëllimet e parashikuara.

2.2 KfW-ja ka të drejtën e refuzimit të bërjes së disbursimeve pas datës 15 dhjetor 2015.

Neni 3 **Pezullimi i disbursimit dhe shlyerja**

3.1 KfW-ja nuk mund të pezullojë disbursimet, përveç kur:

a) Përfituesi nuk përmbush detyrimet e tij kundrejt KfW-së për të bërë pagesat kur bëhen të kërkueshme;

b) Detyrimet sipas kësaj marrëveshjeje ose sipas marrëveshjes së huas për këtë program të datës _____ ose sipas marrëveshjeve të veçanta që i përkasin një prej këtyre marrëveshjeve janë shkelur;

c) Përfituesi nuk është në gjendje të provojë se të gjitha shumat e disbursuara janë përdorur t për qëllimin e parashikuar, ose

d) Lindin rrethana të jashtëzakonshme që përjashtojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e programit;

e) Komisioni Europian i kërkon KfW-së të pezullojë disbursimet.

3.2 Nëse ka ndodhur njëra nga situatat e specifikuar në nenin 3.1 b) ose c) dhe nuk është eliminuar brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja, që, do të jetë të paktën 30 ditë, KfW-ja mund:

a) në rastin e nenit 3.1 b), të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të të gjitha shumave të disbursuara;

b) në rastin e nenit 3.1 c), të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të atyre shumave që përfituesi nuk është në gjendje të provojë se janë përdorur për qëllimin e caktuar.

Neni 4 **Kostua dhe detyrimet publike**

Përfituesi mbulon të gjitha tatimet dhe detyrimet e tjera publike që mblidhen jashtë Republikës Federale Gjermane mbi lidhjen dhe ekzekutimin e kësaj kontrate, si dhe të gjitha kostot e transferimit dhe konvertimit që mblidhen në lidhje me disbursimin e kontributit financiar.

Neni 6 **Deklarimet financiare dhe tagri i përfaqësimit**

6.1 Ministri i Financave dhe ata persona që caktohen prej tij ose asaj për KfW-në dhe që autorizohen prej tij nëpërmjet ekzemplarëve të firmave të certifikuar prej tij ose saj e përfaqësojnë përfituesin në ekzekutimin e kësaj marrëveshjeje. Tagri i përfaqësimit nuk skadon deri në revokimin shprehimisht nga përfaqësuesi i përfituesit të autorizuar në momentin që është marrë nga KfW-ja.

6.2 Ndryshimet ose shtesat e kësaj marrëveshjeje dhe çdo njoftim dhe deklaram i bërë nga palët kontraktuese sipas kësaj marrëveshjeje bëhen me shkrim. Çdo njoftim ose deklaratë e tillë konsiderohet e marrë nëse ajo ka arritur në adresën e mëposhtme të palës kontraktuese përkatëse ose në një adresë tjetër të palës kontraktuese përkatëse sipas njoftimit drejtuar palës tjetër kontraktuese.

Për KfW-në:

KfW
Postfach 11 11 41
60046 Frankfurt am Main
Federal Republic of Germany
Fax: +49 69 7431-2944

Për përfituesin:

Ministria e Financave
Bulevardi: "Dëshmorët e Kombit" nr. 1
Tiranë
Republika e Shqipërisë
Faks: +355-4-222 8494

Neni 7 Programi

7.1 Përfituesi, i përfaqësuar nga njësia e zbatimit të programit:

a) Detyron ndërmarrjet të përgatitin, zbatojnë, operojnë dhe mirëmbajnë nënprojektet në pajtim me praktikat e qëndrueshme financiare dhe teknike dhe thelbësisht në pajtim me konceptin e Programit të rënë dakord ndërmjet njësisë së zbatimit të programit dhe KfW-së;

b) Ia ngarkon përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të nënprojekteve inxhinierëve konsulentë dhe konsulentëve të kualifikuar dhe të pavarur;

c) Siguron që ndërmarrjet lidhin kontrata për mallrat dhe shërbimet që duhet të financohen nga huaja sipas ofertimit paraprak ndërkombëtar konkurrues;

d) Siguron financim të plotë për programin dhe i jep KfW-së me kërkesë të saj prova që provojnë se kostot, të cilat nuk financohen nga kontributi financiar janë mbuluar;

e) Detyron ndërmarrjet të mbajnë regjistra dhe libra që tregojnë qartësisht të gjithë koston e mallrave dhe shërbimeve që kërkohen për programin dhe identifikojnë qartësisht mallrat dhe shërbimet e financuara nga kjo hua;

f) U jep mundësi përfaqësuesve të KfW-së, Komisionit Europian, Bankës së Zhvillimit të Këshillit të Europës dhe/ose Delegacionit të Komisionit Europian në Republikën e Shqipërisë që në çdo kohë të inspektojnë këto regjistra dhe libra dhe çdo dokumentacion tjetër përkatës për zbatimin e Programit, dhe të vizitojnë programin dhe të gjitha instalimet në lidhje me të;

g) I jep KfW-së të gjithë atë informacion dhe regjistra mbi programin dhe përparimin e tij të mëtejshëm që mund të kërkojë KfW-ja. Përfituesi njuh të drejtën e Komisionit Europian për të përdorur falas si ta çmojë të nevojshme të gjitha dokumentet që janë financuar nga ky kontribut financiar;

h) Siguron që të gjitha publikimet ose informacioni tjetër promociional mbi programin të përfshijë një referencë mbi faktin që programi është i bashkëfinancuar nga Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës dhe Bashkimi Europian dhe tregon logon europiane (dymbëdhjetë yje të verdhë mbi një sfond blu); dhe

i) Siguron që, për një periudhë deri në pesë vjet pas përfundimit të programit, Komisioni Europian dhe Gjykata Europiane e Auditëve të jenë në gjendje të kryejnë auditimet e nevojshme për të verifikuar përdorimin e kontributit financiar, mbi bazën e dokumenteve dhe në vend, duke përfshirë të gjitha kontratat dhe nën-kontratat që janë financuar me kontributin financiar. Komisioni Europian dhe Gjykata Europiane e Auditëve kanë të drejtën të dërgojnë agjentët e tyre për të kryer në vend kontrollet dhe inspektimet sipas parashikimit në rregulloren (EC, Euratom) nr. 2185/1996).

7.2 Përfituesi, i përfaqësuar nga njësia e zbatimit të programit dhe KfW-ja përcaktojnë hollësitë në lidhje me nenin 7.1 me marrëveshje të veçantë, që duhet të miratohet nga Huamarrësi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave.

7.3 Në lidhje me transportin e pasagjerëve dhe mallrave me rrugë detare dhe ajrore të realizuara nëpërmjet huas, Qeveria e Shqipërisë lejon pasagjerët dhe furnitorët të zgjedhin një

shoqëri transporti në diskrecionin e tyre dhe nuk zbatojnë asnjë masë që përjashton pjesëmarrjen e shoqërive të transportit me seli në Bashkimin Europian apo e bën atë të vështirë. Për më tepër, nëse kërkohet, Qeveria e Shqipërisë jep pëlqimin e saj për pjesëmarrjen e këtyre shoqërive të transportit.

Neni 8
Dispozita të ndryshme

8.1 Përfituesi siguron që personat e ngarkuar prej tij me përgatitjen dhe zbatimin e programit, dhënien e çdo kontrate për furnizimet dhe shërbimet që duhet të financohen dhe me kërkimin e disbursimeve të shumave të kontributit financiar nuk kërkojnë, marrin, japin apo premtojnë pagesa të paligjshme ose avantazhe të tjera në lidhje me këto detyra.

8.2 Përfituesi i ofron menjëherë KfW-së me kërkesë të gjithë informacionin dhe dokumentet që KfW-ja kërkon për të përmbushur detyrimet e saj për të parandaluar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të raporteve të biznesit me përfituesin, që është i nevojshëm për këtë qëllim.

8.3 Nëse një prej dispozitave të kësaj marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera mbeten të pacenuara prej saj. Çdo boshllëk që rrjedh prej saj mbulohet nga një dispozitë në pajtim me qëllimin e kësaj marrëveshjeje.

8.4 Përfituesi nuk mund të transferojë, lërë peng ose rëndojë me hipotekë asnjë prej pretendimeve nga kjo marrëveshjeje.

8.5 Kjo marrëveshje rregullohet nga ligji i Republikës Federale Gjermane. Vendi i përmbushjes së detyrimit është Frankfurt am Main.

8.6 Marrëdhëniet ligjore të vendosura nga kjo marrëveshje ndërmjet KfW-së dhe përfituesit mbarojnë me përfundimin e kohëzgjatjes së dobishme të programit, por jo më vonë se 15 vjet pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje.

8.7 Kjo marrëveshje hyn në fuqi me përmbushjen e procedurave të brendshme ligjore nga përfituesi. Përfituesi informon KfW-në menjëherë nëse ndodh kjo.

Bërë në 2 kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main,
më 2010
KfW

Tiranë,
më 2010
Republika e Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria
e Financave

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
Sheshi Skënderbej nr.5,
Tiranë
Shqipëri

Eva Schneider
tona. SEv
tel: +49 (0)69 7431 3648
e-mail: eva.schneider@kfw.de
Datë:

L III/a4 Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë
Programi “Infrastruktura bashkiake I”
16 milionë euro (huaja)
BMZ-nr: 2009 66 523
4,621,500 euro (kontributi financiar)
Marrëveshje e veçantë për marrëveshjen e huas dhe programit datë dhe për
marrëveshjen financiare për kontributin financiar të dhënë nga Bashkimi European e datës
.....

Të nderuar zotërinj,

Ne i referohemi marrëveshjes së huas të datës @ ndërmjet KfW-së dhe Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Ministria e Financave (Huamarrësi) dhe marrëveshjes së financimit të lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave (përfituesi) dhe KfW-së datë Marrëveshjet e lartpërmendura njihen për secilën prej UK Lezhë, UK Gjirokastrë, UK Sarandë dhe UK Fier (së bashku “Agjencitë e zbatimit të projektit”, secila “Agjenci e zbatimit të projektit”) që veprojnë si agjenci të zbatimit të projektit (PEA) të programit. Secila prej agjencive të zbatimit të projektit bie dakord me marrëveshjen e huas dhe marrëveshjen e financimit dhe veçanërisht njihin rolin e tyre duke vepruar si agjenci e zbatimit të projektit në lidhje me projektin dhe bie dakord të marrë përsipër të drejtat dhe detyrimet përkatëse dhe të përmbushë si duhet detyrimet e saj sipas marrëveshjes së huas dhe marrëveshjes së financimit në lidhje me programin siç përcaktohet më tej në marrëveshjen e huas dhe marrëveshjen e financimit dhe siç përcaktohet më tej këtu. Në pajtim me marrëveshjen e huas dhe marrëveshjen e financimit, sa më poshtë përcaktohet me marrëveshje të veçantë:

Në pajtim me nenin 1.2 të marrëveshjes së huas dhe marrëveshjes së financimit:

Hollësitë e programit, si dhe mallrat dhe shërbimet që financohen nga huaja;

Në pajtim me nenin 3.4 të marrëveshjes së huas dhe nenin 2.1 të marrëveshjes së financimit:

Procedura e disbursimit, veçanërisht provat që provojnë se shumtat e huas së disbursuar përdoren për qëllimet e caktuara;

Në pajtim me nenin 11.2 të marrëveshjes së huas dhe nenin 7.2 të marrëveshjes së financimit:

Hollësitë që i përkasin nenit 7.1 të marrëveshjes së huas dhe marrëveshjes së financimit.

Ne propozojmë që të bihet dakord sa më poshtë:

I. Projektimi i programit

1. Hollësitë e programit

Programi mbulon përmirësimin e furnizimit me ujë dhe situatën e kanalizimeve në bashkitë e Gjirokastrës, Fierit, Lezhës dhe Sarandës. Qëllimi i programit është sigurimi i një furnizimi të qëndrueshëm me ujë higjienikisht të sigurt për popullatën e qyteteve të programit me mbulimin e kostos dhe tarifa të mundshme për t’u paguar nga popullata, si dhe sigurimi i një higjiene të përshtatshme nëpërmjet kanalizimeve. Kjo do të kontribuojë në një përdorim efikas të burimeve ujore dhe për mbrojtjen e ambientit me përmirësimin paralel të kushteve të jetesës, punës dhe shëndetit për popullatën. Kriteret për arritjen e këtyre objektivave, rezultatet e programit dhe aktivitetet e duhura të programit, si dhe kushtet për arritjen e qëllimit të programit dhe rezultatet e programit gjenden në aneksin 1.

Projektimi i programit bazohet në misionet për mbledhjen e informacionit nga Nuri Balsari dhe Gunter Wagner, të datës tetor 2008, analizën institucionale nga MACS GmbH dhe studimet e fizibilitetit nga IMS dhe IncoWest të datës tetor 2009 që iu ofrua KfW-së, Huamarrësit, Ministrisë

së Punëve Publike dhe Transportit, që vepron si njësi e zbatimit të programit (njësia e zbatimit të programit) dhe ndërmarrjet e ujit (agjencitë e zbatimit të programit) dhe mbi marrëveshjet e lidhura ndërmjet KfW-së, Huamarrësit, njësisë së zbatimit të programit dhe agjencive të zbatimit të programit gjatë vlerësimit të programit lokal në nëntor 2009 të parashikuara në protokollin e mbledhjes të datës 2 shkurt 2010.

Aktivitetet e mëposhtme të programit do të financohen nga huaja dhe/ose kontributi financiar:

- Gjirokastrë: Zëvendësim i pjesshëm i linjës së transmetimit nga burimi Hos, lidhje me fshatin Valare me furnizimin me ujë, ndërtimin e kapacitetit shtesë të rezervuarit të Palortosë dhe zëvendësimi i rrjetit të furnizimit me ujë në qytetin e ri të Gjirokastrës;

- Fier: Rehabilitimi i rrjetit të shpërndarjes në qytetin e Fierit, duke përfshirë shtrirjen e zonave të ndara dhe linjave të transmetimit në shtrirjen e rrjetit të shpërndarjes në Afrim dhe Bishanak;

- Sarandë: Rehabilitimi i linjës kryesore dhe rrjetit të shpërndarjes në qendrën e qytetit të Sarandës, rehabilitimi dhe ndërtimi i rezervuarëve dhe ndërtimi i linjës kryesore dhe rrjetit të shpërndarjes ndërmjet Hotelit të Butrintit dhe kanalit të Cukës;

- Lezhë: Rehabilitimi i rezervuarit, ndërtimi i linjës kryesore dhe rrjetit të shpërndarjes në lagjen Strauss, ndërtimi i linjës kryesore dhe rrjetit të shpërndarjes për Balldrenin.

2. Grafiku kohor

Grafiku kohor përkatës për përgatitjen, zbatimin dhe operimin e programit gjendet në aneksin 2.

3. Kostoja totale dhe financimi

Kostoja totale e parashikuar e programit (kostoja totale) sipas vlerësimit të programit është afërsisht 20.62 milionë euro. Shuma e huas është 16 milionë euro për të financuar investimet dhe kostot përkatëse në vendet e programit Fier, Lezhë, Gjirokastrë dhe Sarandë. Përveç kësaj, do të jepet një grant nga BE-ja (kontributi financiar) i siguruar nga pjesa bashkiake e instrumentit të projektit në infrastrukturë (IPF-MW) prej 4,621,500 euro për të financuar masat në Fier dhe Gjirokastrë. Përbërja e koston totale dhe planit të financimit gjenden në aneksin 3.

4. Ndryshimet në projektimin e programit

Çdo ndryshim i konsiderueshëm në projektimin e programit kërkon pëlqimin paraprak të KfW-së dhe Huamarrësit. Njësia e zbatimit të projektit dhe/ose agjencitë e zbatimit të projektit informojnë menjëherë për këtë KfW-në, duke deklaruar arsyet, masat e planifikuara dhe pasojat e ndryshimeve (përfshirë koston totale). Ekzekutimi i këtyre masave mund të fillojë vetëm mbi bazën e planifikimit të rishikuar dhe me pëlqimin e KfW-së.

II. Zbatimi i programit

1. Përgjegjësitë dhe koha, kostoja dhe grafiku i financimit

1.1 Ministria e Punëve Publike dhe Transportit është përgjegjëse për zbatimin e programit. Brenda këtij institucioni, personeli i vendosur në Drejtorinë e Përgjithshme për Furnizimin me Ujë dhe Kanalizimet (GDWSS) caktohet për të formuar njësinë e zbatimit të programit (PIU). Ndërmarrjet e ujit që janë pjesërisht në pronësi të katër bashkive do të jenë në ngarkim të zbatimit dhe operimit të projekteve individuale, nën mbikëqyrjen e PIU-t. Të gjitha palët do të bashkëpunojnë ngushtësisht gjatë përgatitjes dhe zbatimit të programit dhe përcaktojnë me marrëveshje të përbashkët aspektet e programit që janë thelbësore për operimin e tij.

1.2 Koha, kostoja dhe grafiku financiar i detajuar, i përditësuar rregullisht për zbatimin e duhur teknik dhe financiar të programit, përgatiten sa më shpejt të jetë e mundur nga njësia e zbatimit të programit në bashkëpunim me konsulentin dhe i paraqiten KfW-së. Ky grafik duhet të tregojë, me afate dhe shuma, ndërlidhjen e parashikuar kronologjike të aktiviteteve të programit dhe kërkesat përkatëse financiare. Nëse një devijim nga një grafik i tillë bëhet i nevojshëm gjatë zbatimit të programit, KfW-së i vihet në dispozicion një grafik i rishikuar.

2. Caktimi i një konsulenti

2.1 Bazuar në dokumentacionin e disponueshëm, ndërmarrjet e ujit në Fier, Gjirokastrë, Lezhë dhe Sarandë, me asistencën e konsulentit të zbatimit (konsulenti i zbatimit) do të realizojnë projektet e detajuara, përpilojnë dokumentet e tenderit dhe prokurojnë mallrat dhe shërbimet. Edhe konsulenti i zbatimit do të asistojë ndërmarrjet e ujit në mbikëqyrjen e punëve të ndërtimit dhe periudhën e përgjegjësisë për defektet. Konsulenti i zbatimit do të kontraktohet nga njësia e zbatimit të programit. Në rast se shuma e kontratës së konsulentit kalon së tepërmi buxhetin sipas aneksit 3, Huamarrësi duhet të aprovojë buxhetin e rishikuar.

2.2 Për masat institucionale në Fier dhe Gjirokastrë dhe mbase në Sarandë dhe Lezhë, një konsulent institucional (konsulenti institucional) do të përfshihet për të mbështetur ndërmarrjet për të ulur humbjet administrative (për t'u financuar nga kontributi financiar). Ky konsulent institucional do të kontraktohet nga njësia e zbatimit të programit.

2.3 Pas parazgjedhjes dhe ofertimit ndërkombëtar publik konkurrues, të dyja detyrat (për konsulentin e zbatimit dhe konsulentin institucional) jepen në kontrata të veçanta të shoqëritë e pavarura të kualifikuara të konsulencës. Procedura për dhënien e kontratës rregullohet nga "Udhëzimet për caktimin e konsulentëve në bashkëpunimin financiar me vendet në zhvillim" (aneksi 4), që përbën pjesë integrale të saj. Dokumentet e tenderit do të përfshijnë një deklaratë që përshtatshmëria e ofertuesve, midis faktorëve të tjerë, do t'i nënshtrohet verifikimit nga Bashkimi Europian (BE) në bazë të sistemit të brendshëm të BE-së për njoftimin e hershëm.

2.4 Në njoftimin e para-kualifikimit ose, nëse nuk është zhvilluar para-kualifikim, në ftesën për ofertë, njësia e zbatimit të programit do të detyrojë ofertuesit të paraqesin së bashku me dokumentet e ofertës ose së bashku me ofertën një deklaratë të ndërmarrjes të nënshkruar rregullisht (aneksi 4, faqe 16).

2.5 Njësia e zbatimit të programit i kërkon KfW-së të autorizojë një ekspert (agjent tenderi) për të asistuar njësinë e zbatimit të programit në zgjedhjen dhe kontraktimin e konsulentit të zbatimit dhe konsulentit institucional. Veçanërisht, agjenti i tenderit do të asistojë njësinë e zbatimit të programit me shërbimet e mëposhtme:

- Hartimin e termave të referencës për shërbimet e konsulencës, duke përfshirë një projekt-kontratë konsulencë (kontrata standarde e konsulencës së KfW-së);
- Përbushjen e para-kualifikimit dhe "listës së përzgjedhur" për ofertuesit e kualifikuar;
- Realizimin e tenderit duke përfshirë një propozim të justifikuar për dhënien e kontratës;
- Paraqitjen e një projekt-kontrate konsulencë që është negociuar me konsulentët.

Kostot e shkaktuara për agjentin e tenderit do të mbulohen nga një fond granti që jepet për këtë qëllim nga Ministria Federale Gjermane për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik (BMZ).

2.6 Brenda dy javëve pasi njësia e zbatimit të programit dhe KfW-ja të kenë marrë propozimet e agjentit të tenderit në lidhje me termat e referencës, propozimet për dhënien e kontratave dhe projekt-kontratave të konsulencës, ata do të komentojnë për këto.

2.7 Në përgatitje të mbështetjes institucionale për ndërmarrjet e ujit, plani i rregullimit të tarifave dhe plani i biznesit të çdo ndërmarrjeje uji duhet të përditësohet. Fondet për studimin përkatës që ndërmerret nga një ekspert ndërkombëtar, jepen, gjithashtu, nga fondi i veçantë i grantit të përmendur në pikën 2.5.

3. Dhënia e kontratave për mallrat dhe shërbimet e tjera

3.1 Kontratat për mallrat dhe të gjitha shërbimet e tjera jepen në bashkëpunim me konsulentin e zbatimit nëpërmjet tenderimit konkurrues ndërkombëtar.

3.2 Përveç tenderimit të matësve të ujit që do të jetë i kombinuar për të katër qytetet, të gjitha kontratat e tjera për mallrat dhe shërbimet do të jepen veçmas nga ndërmarrjet e veçanta të ujit në qytetet e Fierit, Gjirokastrës, Lezhës dhe Sarandës.

3.3 Dokumentet e tenderit do t'i jepen KfW-së për komente në kohën e duhur para publikimit të ftesës për tender. Dokumentet e tenderit do të përfshijnë një deklaratë që përshtatshmëria e ofertuesve, midis faktorëve të tjerë, do t'i nënshtrohet verifikimit nga Bashkimi Europian (BE) në bazë të sistemit të brendshëm të BE-së për njoftimin e hershëm.

3.4 Periudha e ofertimit do të rregullohet në mënyrë të tillë që u jep ofertuesve kohë të mjaftueshme për të përgatitur ofertat e tyre.

3.5 Hollësitë që mbeten në lidhje me procedurën e dhënies dhe kushtet kontraktuale shpjegohen në “Udhëzimet për prokurimin e furnizimit dhe kontratat e punëve sipas bashkëpunimit financiar me vendet në zhvillim” (aneksi 5), që përbën pjesë integrale të kësaj marrëveshjeje.

3.6 Në njoftimin e parakualifikimit ose, nëse nuk zhvillohet parakualifikim, në dokumentet e tenderit, agjencitë e zbatimit të programit detyrojnë ofertuesit të paraqesin së bashku me dokumentet e parakualifikimit ose së bashku me ofertën një deklaratë sipërmarrjeje (aneksi 5, faqe 27).

3.7 Gjatë lidhjes së kontratave për mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga huaja, agjencitë e zbatimit të programit respektojnë, gjithashtu, parimet e mëposhtme:

a) Meqenëse detyrimet e importit nuk mund të financohen nga huaja në pajtim me nenin 1.3 të marrëveshjes së huas dhe programit, këto detyrime importi, nëse janë pjesë e vlerës së kontratës, pasqyrohen veçmas në kontratat për mallrat dhe shërbimet dhe në fatura.

b) Nëse pagesat e kërkueshme në pajtim me kontratat e mallrave dhe shërbimeve duhet të bëhen nga huaja, këto kontrata do të përfshijnë një dispozitë që parashikon se çdo rimbursim, garanci ose pagesë e kërkueshme e ngjashme dhe çdo pagesë e rimbursueshme bëhet për llogari të Huamarrësit në llogarinë nr.38 000 000 00 (IBAN: DE53 5002 0400 3800 0000 00) te KfW, Frankfurt am Main (BIC: KFWIDEFF; BLZ 500 204 00), ku KfW-ja krediton këto pagesa në llogarinë e Huamarrësit. Nëse këto pagesa bëhen në monedhën lokale, ato dërgohen në një llogari të veçantë të agjencisë së zbatimit të programit në vendin e agjencisë së zbatimit të programit, që mund të tërhiqen vetëm me pëlqimin e kfw-së. këto fonde mund të ripërdoren për zbatimin e programit me pëlqimin e KfW-së.

3.8 Para lidhjes së kontratës për mallrat dhe shërbimet, KfW-së i vihet në dispozicion për koment një projekt-kontratë, siç është rënë dakord, e dhënë rregullisht me miratimin e konsulentit të zbatimit. Kjo zbatohet edhe për çdo marrëveshje ndryshuese ose modifikuese.

4. Marrëveshjet e veçanta të zbatimit

4.1 Para kontraktimit të shërbimeve të konsulentit të zbatimit, detyrat e mëposhtme duhet të jenë përmbushur nga ndërmarrjet e ujit: Një koncept për përshtatjen e tarifës dhe mbulimin e kostos është zhvilluar ose përditësuar përkatësisht dhe aprovuar nga bordi mbikëqyrës i ndërmarrjeve të ujit dhe nga Rregullatori (ERRU).

4.2 Para tenderimit të mallrave dhe shërbimeve, një auditues i jashtëm ka vërtetuar që UK Lezha ka arritur 65% të mbulimit të kostos në vitin 2011, UK Gjirokastra ka arritur 90% të mbulimit të kostos në vitin 2011, Saranda ka arritur 70% të mbulimit të kostos në vitin 2011 dhe Fier ka arritur 90% të mbulimit të kostos, duke përfshirë shërbimin e borxhit në vitin 2011.

4.3 Para kontraktimit të mallrave dhe shërbimeve, një propozim për rritjen e tarifës është aprovuar nga bashkitë përkatëse dhe paraqitur rregullatorit (ERRU) që tregon qartësisht që UK Lezha ka arritur 80% të mbulimit të kostos në vitin 2012, UK Gjirokastra ka arritur 100% të mbulimit të kostos në vitin 2012, Saranda ka arritur 90% të mbulimit të kostos në vitin 2012 dhe Fier ka arritur 100% të mbulimit të kostos, duke përfshirë shërbimin e borxhit në vitin 2012.

4.4 Ndërmarrjet e ujit do të zbatojnë më tej masat e mëposhtme për të rritur normën e mbulimit të kostos:

Lezhë:

- Rritje e tarifës vjetore për ujin të paktën 15% për vitet 2010 deri 2012;
- Instalimi i 2000 matësve të ujit;
- Faturim i përmirësuar dhe raporte të përmirësuara me klientët;

Gjirokastër:

- Rritje e tarifës vjetore për ujin të paktën 20% për vitet 2010 deri 2012, dhe të paktën 2% p.a. në vitet në vazhdim;

- Instalimi i 5 000 matësve të ujit;

- Faturim i përmirësuar dhe raporte të përmirësuara me klientët;

Sarandë:

- Rritje e tarifës vjetore për ujin, të paktën 15% për ekonomitë shtëpiake dhe të paktën 10% për shoqëritë private dhe institucionet publike për vitet 2010 deri 2012;
- Faturim i përmirësuar dhe arkëtime të përmirësuara;
- Instalimi i 4 500 matësve të ujit;
- Raporte të përmirësuara me klientët;

Fier:

- Rritje e tarifës vjetore për ujin të paktën 16% për ekonomitë shtëpiake për vitet 2010 dhe 2011 dhe të paktën 5% p.a. për vitet në vazhdim;
- Rritje tarife vjetore për ujin me të paktën 6% për shoqëritë private dhe të paktën 10% për institucionet publike dhe industrinë për vitet 2010 dhe 2011;
- Rritje e tarifës vjetore për kanalizimet me të paktën 18% për shoqëritë private dhe të paktën 25% për institucionet publike dhe industrinë dhe të paktën 35% për ekonomitë shtëpiake për vitet 2010 dhe 2011;
- Instalimi i 10 000 matësve të ujit;
- Faturim i përmirësuar dhe arkëtime të përmirësuara;
- Raporte të përmirësuara me klientët.

4.5 Para lidhjes së kontratës me konsulentin, secila ndërmarrje zbaton rimbursimin ose përjashtimin nga TVSH-ja dhe tatimet për të gjitha mallrat dhe shërbimet nga Qeveria Shqiptare.

5. Kushtet për operimin e duhur të programit

5.1 Me qëllim që të sigurohet operimi i duhur i programit, njësia e zbatimit të programit paraqet një koncept të mirëmbajtjes dhe operimit të përpiluar në bashkëpunim me ndërmarrjet dhe konsulentin e zbatimit të paktën 6 muaj para autorizimit të programit.

5.2 Në të njëjtën kohë, agjencitë e zbatimit të programit i paraqesin KfW-së një parashikim buxheti, të përpiluar në bashkëpunim me konsulentin e zbatimit, për zonën e operimit në të cilin gjendet programi. Ky parashikim duhet të tregojë që është siguruar financimi për operimin e tij. Agjencitë e zbatimit të programit përditësojnë periodikisht këtë parashikim dhe sigurojnë që çdo boshllëk financimi të mbulohet në kohën e duhur. Agjencitë e zbatimit të programit ia transmetojnë KfW-së pa vonesë këtë parashikim buxheti dhe versionet e rishikuara.

6. Caktimi i një auditi

6.1 Një auditim vjetor për realizimin e kontributit financiar të dhënë nga Bashkimi Europian (audituesi) kryhet në bazë të këtij programi.

6.2 Audituesi përzgjidhet pas ofertimit ndërkombëtar konkurrues dhe certifikon çdo vit realizimin e duhur të kontributit financiar të dhënë nga Bashkimi Europian deri në përfundimin e programit.

6.3 Auditimi i kontributit financiar të dhënë nga Bashkimi Europian do të financohet nga kontributi financiar.

6.4 Termat e referencës për auditin bazohen në termat standarde të referencës që do të paraqiten nga KfW-ja para caktimit të audituesit.

III. Lista e mallrave dhe shërbimeve dhe procedura e disbursimit

1. Lista e mallrave dhe shërbimeve

1.1 Lista e mallrave dhe shërbimeve që do të financohen nga huaja përgatitet në bazë të kontratave të përfunduara për këto mallra dhe shërbime. Po ashtu, KfW-së i paraqitet origjinali ose një kopje e secilës prej këtyre kontratave dhe e çdo kontrate përkatëse ndryshuese.

1.2 Nëse një masë programi duhet të zbatohet dhe për këtë nuk është lidhur kontratë, KfW-ja, në mungesë të kontratave, duhet të marrë një grafik të masave të planifikuara, të detajuara në kategori të kostos kryesore (grafiku i masave pa kontratë paraprake). Kostoja e shkaktuar për administrim të përgjithshëm në lidhje me punën pa kontratë paraprake nuk duhet të përfshihet në grafikun e lartpërmendur të masave pa kontratë paraprake.

1.3 KfW-ja informon njësinë e zbatimit të programit, me kërkesë, për shumat e huas që ka rezervuar për financim (listën e mallrave dhe shërbimeve).

2. Procedura e disbursimit

Disbursimi rregullohet nga rregullat e parashikuara në aneksin 6 (procedura e disbursimit) që përbën pjesë integrale të kësaj marrëveshjeje.

Kontributi financiar i dhënë nga Bashkimi Europian përdoret vetëm për të financuar kontratat për mallrat dhe shërbimet që janë dhënë pas ofertimit konkurrues ndërkombëtar për projektet e Gjirokastrës dhe Fierit. Pagesat sipas këtyre kontratave disbursohen proporcionalisht nga Kontributi Financiar i dhënë nga Bashkimi Europian dhe Huaja e dhënë në kuadrin e Bashkëpunimit Financiar Gjerman për këto kontrata. I vetmi përjashtim është konsulenti institucional për Gjirokastrën dhe Fierin, të përmendur në nenin II.2.2 që do të paguhet vetëm nga kontributi financiar.

IV. Raportimi dhe dispozita të tjera

1. Raportimi

1.1 Deri në një njoftim të mëtejshëm, njësia e zbatimit të programit i raporton KfW-së çdo semestër për progresin e programit (raportet e progresit) dhe marrëveshjet e zbatimit të parashikuara në seksionin II.4 të kësaj marrëveshjeje dhe mbi zhvillimin e të gjitha kushteve të përgjithshme të rëndësishme. Raportet kërkohen në ditën e fundit të muajit pas çdo semestri të një viti (30 prill, 31 korrik, 31 tetor, 31 janar). Raportimi i parë është i kërkuar më 31.1.2011. Përveç kësaj, njësia e zbatimit të programit raporton për të gjitha rrethanat që mund të rrezikojnë arritjen e objektivave të përgjithshme, qëllimin dhe rezultatet e programit. Në momentin e përfundimit fizik dhe autorizimit të programit, por para skadimit të periudhës së garancisë, njësia e zbatimit të programit paraqet një raport përfundimtar mbi masat e zbatuara. Raportet siglohen nga konsulenti.

1.2 Nëse njësia e zbatimit të programit ka ngarkuar konsulentin të përpilojë raportet e progresit dhe/ose raportin përfundimtar, njësia e zbatimit të programit komenton mbi raportet ose bën të ditur aprovimin e përmbajtjes duke sigluar raportet.

1.3 Pas përfundimit të programit, njësia e zbatimit të programit raporton mbi zhvillimin e mëtejshëm (shihni aneksin 7 për hollësi). KfW-ja njofton në kohën e duhur njësinë e zbatimit të programit në lidhje me fundin e periudhës së raportimit.

2. Dispozita të tjera

2.1 Njësia e zbatimit të programit dhe agjencitë e zbatimit të projektit i dërgojnë KfW-së të gjitha dokumentet që janë të nevojshme për KfW-në për të dhënë komentet dhe aprovimet e përmendura më sipër mbi udhëzimet e bashkëlidhura, në kohë të arsyeshme për të dhënë kohë për shqyrtim.

2.2 Huamarrësi vendos pllakate për programin që përmbajnë të paktën mesazhet e mëposhtme:

“Një program zhvillimi i Qeverisë së Shqipërisë, i bashkëfinancuar nga Bashkimi Europian dhe Republika Federale e Gjermanisë nëpërmjet KfW-së”.

Një vulë programi e dhënë nga Ambasada Gjermane dhe logoja europiane (dymbëdhjetë yje të verdhë mbi një sfond blu) vendosen në pllakatin e programit.

2.3 Të gjitha automjetet dhe pajisjet e prokuruar nga konsulenti për programin do t'i transferohen njësisë së zbatimit të projektit pas përfundimit të programit. Prova dokumentuese e transferimit mbahet nga njësia e zbatimit të programit deri në pesë vjet pas përfundimit të programit.

2.4 Njësia e zbatimit të programit siguron që të gjithë dokumentet e nxjerra nga konsulenti të përfshijnë një referencë ndaj faktit që programi është bashkëfinancuar nga Bashkimi Europian dhe tregon logon europiane (dymbëdhjetë yje të verdhë mbi një sfond blu). Kjo zbatohet edhe për automjetet dhe pajisjet që janë prokuruar nga konsulenti për programin derisa t'i transferohen njësisë së zbatimit të programit pas përfundimit të programit.

2.5 Njësia e zbatimit të programit publikon hollësitë e mëposhtme për të gjitha kontratat që financohen sipas kësaj marrëveshjeje në faqen e internetit: titulli dhe tipi i kontratës, adresa dhe kombësia e kontraktorit, shuma e kontratës.

2.6 Njësia e zbatimit të programit siguron që i gjithë dokumentacioni që mbulon përgatitjen e programit dhe zbatimin të ofrohet për auditim të paktën 5 vjet pas përfundimit të programit. Njësia e zbatimit të programit siguron, gjithashtu, që Komisioni Europian ose përfaqësuesit e tij të jenë në

gjendje të kryejnë vlerësime për programin paraprakisht, gjatë ose pas zbatimit të tij.

2.7 Dispozitat e mësipërme mund të ndryshohen ose modifikohen në çdo kohë me marrëveshje reciproke nëse kjo është e dobishme për zbatimin e programit ose ekzekutimin e marrëveshjes së huas dhe programit. Në të gjitha aspektet e tjera, dispozitat e neneve 13.2 dhe 14 të marrëveshjes së huas zbatohen përkatësisht për këtë marrëveshje.

Jeni të lutur të jepni pëlqimin për marrëveshjen e mësipërme duke nënshkruar në një formë ligjrisht të detyrueshme dhe të ktheni kopjet e bashkëlidhura.

Ne bashkëlidhim një kopje të kësaj letre me kërkesën për t'ua transmetuar në kohën e duhur bashkive në Fier, Gjirokastrë, Lezhë dhe Sarandë.

Jeni të lutur t'i transmetoni një kopje të kësaj letre në kohën e duhur Konsulentit.

Me respekt, KfW

KfW

Lexuar dhe rënë dakord:

Tiranë më 2010

Ministria e Financave (Huamarrësi)

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit

Ujësjiellësi Fier

Ujësjiellësi Gjirokastrë

Ujësjiellësi Lezhë

Ujësjiellësi Sarandë

Anekset

Aneksi 1: Objektivat dhe rezultatet e programit dhe kushtet për arritjen e tyre

Aneksi 2: Grafiku kohor

Aneksi 3: Kostoja dhe financimi total

Aneksi 4: Udhëzime për caktimin e konsulentëve në bashkëpunimin financiar me vendet në zhvillim


Aneksi 5: Udhëzime për prokurimin e kontratave të furnizimit dhe punëve në kuadrin e bashkëpunimit financiar me vendet në zhvillim

Aneksi 6: Procedura e disbursimit

Aneksi 7: Përmbajtja dhe forma e raportimit

Programi i infrastrukturës bashkiake I

Detaje të programit



ANEKSI 2
GRAFIKU KOHOR
INSTRASTRUKTURA BASHKIAKE I, SHQIPËRI

Nr.	Emërtimi	2010				2011				2012				2013				2014				2015				2016			
		Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3	Q4	Q1	Q2	Q3
1	Përgatitja																												
2	Zgjedhja e konsulentit të implementimit																												
3	Dizenjimi																												
4	Përgatitja e studimeve																												
5	Tenderimi i matësve të ujit																												
6	Dizenjimi i detajuar dhe dokumentet e tenderit																												
7	Tenderimi dhe lidhja e kontratës																												
8	Ndërtimi																												
9	Instalimi i matësve të ujit																												
10	Punime ndërtimi në Lezhë																												
11	Punime ndërtimi në Gjirokastrë																												
12	Punime ndërtimi në Sarandë																												
13	Punime ndërtimi në Fier																												
14	Punime të tjera																												
15	Periudha e pritshmërisë së defekteve																												

ANEKSI 3

Kostoja dhe Financimi				
Rezultatet / Masat e Projektit		Kostot	Financimi	
			Huaja e KfW	Granti i BE-
		EURO	EURO	EURO
A	LEZHE			
A1	Furnizimi me uje	1,460,000	1,460,000	
A2	Kanalizimet	940,000	940,000	
A3	Pajisjet operative	250,000	250,000	
A4.1	Sherbimet e konsulences, Zbatimi	345,000	345,000	
A4.2	Shebimet e konsulences, Fuqizimi institucional*	245,000		
A5	Masat e paparashikuara**	105,000	105,000	
A6	Totali Lezhe	3,345,000	3,100,000	0
B	GJIROKASTRA			
B1	Furnizimi me uje	3,036,938	2,005,000	1,031,938
B2	Kanalizimet	1,946,938	915,000	1,031,938
B3	Pajisjet operative	130,000	130,000	
B4.1	Sherbimet e konsulences, Zbatimi	816,500	816,500	
B4.2	Shebimet e konsulences, Fuqizimi institucional*	246,875		246,875
B5	Masat e paparashikuara**	133,500	133,500	
B6	Totali Gjirokastra	6,310,750	4,000,000	2,310,750
C	SARANDA			
C1	Furnizimi me uje	2,710,000	2,710,000	
C2	Kanalizimet	530,000	530,000	
C3	Pajisjet operative	100,000	100,000	
C4.1	Sherbimet e konsulences, Zbatimi	566,500	566,500	
C4.2	Shebimet e konsulences, Fuqizimi institucional*	245,000		
C5	Masat e paparashikuara**	93,500	93,500	
C6	Totali Saranda	4,245,000	4,000,000	0
D	FIER			
D1	Furnizimi me uje	4,323,875	2,260,000	2,063,875
D2	Kanalizimet	1,450,000	1,450,000	
D3	Pajisjet operative	290,000	290,000	
D4.1	Sherbimet e konsulences, Zbatimi	765,500	765,500	
D4.2	Shebimet e konsulences, Fuqizimi institucional*	246,875		246,875
D5	Masat e paparashikuara**	134,500	134,500	
D6	Totali Fier	7,210,750	4,900,000	2,310,750
Totali		21,111,500	16,000,000	4,621,500
	TVSH, Tatimet dhe Detyrimet			

* Boshllëku ekzistues në financim prej 490 000 euro për shërbimet e konsulencës për forcimin institucional në Lezhë dhe Sarandë planifikohet të mbulohet me fondet e EU-IPA 2010.

** Masat e paparashikuara janë për investimet dhe tarifat e konsulencës.

ANEKSI 4
UDHËZIME PËR CAKTIMIN E KONSULENTËVE NË BASHKËPUNIMIN FINANCIAR ME
VENDET NË ZHVILLIM

Lidhja me udhëzimet:
http://www.kfw-entwicklungsbank.de/DE_Home/Service_und_Dokumentation/Online_Bibliothek/PDF-Dokumente_Richtlinien/Consultingrichtlinie_E_11_200615701.pdf

ANEKSI 5
UDHËZIMET PËR PROKURIMIN E KONTRATAVE TË FURNIZIMIT DHE PUNËVE NË
KUADRIN E BASHKËPUNIMIT FINANCIAR ME VENDET NË ZHVILLIM

Lidhja me udhëzimet:
http://www.kfw-entwicklungsbank.de/DE_Home/Service_und_Dokumentation/Online_Bibliothek/PDF-Dokumente_Richtlinien/Vergaberichtlinie_E_05_2007.pdf

ANEKSI 6
PROCEDURA E DISBURSIMIT

Nëpunësi përgjegjës: Caroline Möller
tel: +49 69 7431-3542
email: caroline.moeller@kfw.de

PROCEDURA E DISBURSIMIT

Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë
Marrëveshje e huas/financimit/programit të KfW-së
Emri i programit: Infrastruktura bashkiake I
16 milionë euro – huaja
Nr. i referencës së KfW-së 2009-66-523
4,621,500 euro – kontributi financiar (marrëveshje e delegimit për fondet EU IPF/MW)
Numri i referencës së KfW-së.: 2020 59 988

HYRJE

Ky aneks përcakton procedurën e disbursimit për programin e sipërpërmendur. Marrëveshja e veçantë duke përfshirë këtë aneks ofrohet për të gjithë personelin e huamarrësit, përfituesin, ose njësinë zbatimit të projektit (pala e autorizuar) dhe çdo palë tjetër të përfshirë në disbursime, që kanë shoqëritë e ujësjellësit UK Lezhë, UK Gjirokastër, UK Sarandë dhe UK Fier (së bashku agjencitë e zbatimit të projektit, secila një agjenci e zbatimit të projektit).

KfW-ja disburson hua dhe kontribute financiare të pashlyeshme (fondet) me kërkesën e palës së autorizuar, në pajtim me progresin e projekteve/programeve të financuara. KfW-ja mbikëqyr përdorimin kontraktual të fondeve që ka rezervuar për mallrat dhe shërbimet specifike mbi bazën e “marrëveshjes së veçantë” që i përket marrëveshjes së huas/financimit/programit.

Lista e mallrave dhe shërbimeve, si dhe fondet përkatëse të rezervuara në këtë mënyrë formojë kuadrin brenda të cilit pala e autorizuar mund të kërkojë disbursimin nga KfW-ja menjëherë sapo të jenë përmbushur parakushtet për disbursim.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Të gjitha aplikimet për tërheqje:

- tregojnë numrin e referencës së KfW-së;
- numërohen në mënyrë të njëpasnjëshme, dhe
- nënshkruhen nga përfaqësuesit e palës së autorizuar që janë caktuar si të autorizuar përballë KfW-së dhe për të cilët KfW-ja ka marrë ekzemplarët e nënshkrimeve (shembull shihni shtojcën A).

Në përgjithësi, KfW-ja pranon vetëm kërkesa origjinale për tërheqje. Nëse, në raste të veçanta, një kërkesë për tërheqje është transmetuar me faks, origjinali duhet të dërgohet me postë menjëherë pas kësaj me shënimin si konfirmim për faksin. KfW-ja lirohet nga pala e autorizuar nga detyrimi për çdo dëm që rrjedh nga transmetimet e rreme, që kërkohet veçanërisht për shkak të gabimeve në transmetim, abuzim, keqkuptim ose gabim.

Për pagesat e bëra në një monedhë të ndryshme se ajo e caktuar (monedha e huaj), KfW-ja debiton huamarrësin ose marrësin me atë shumë që është shpenzuar nga KfW-ja për prokurimin e monedhës së huaj, duke përfshirë shpenzimet e rastësishme.

KfW-ja nuk do të jetë përgjegjëse për vonesat e shkaktuara nga institucionet bankare transferuese në disbursimin ose dërgimin e fondeve. Nëse një vonesë shkaktohet nga KfW-ja, detyrimi i saj kufizohet në pagesën e interesit të mbledhur.

DISPOZITA TË VEÇANTA

Pala e autorizuar është Ministria e Punëve Publike dhe Transportit (MPPT).

Procedura që duhet të zbatohet

Fondet e caktuara për mallrat dhe shërbimet e specifikuar në marrëveshjen e veçantë I.1. + I.3 konsultimi disbursohen në pajtim me procedurën e disbursimit të drejtpërdrejtë.

Fondet e caktuara për mallrat dhe shërbimet e specifikuar në marrëveshjen e veçantë 1.1. + 1.3 Investimet disbursohen në pajtim me procedurën e disbursimit të drejtpërdrejtë të thjeshtuar.

Kontributi Financiar i dhënë nga Bashkimi Europian do të përdoret vetëm për të financuar kontratat për mallrat dhe shërbimet që janë dhënë pas ofertimit konkurrues ndërkombëtar të projekteve në Gjirokastrë dhe Fier. Pagesat sipas këtyre kontratave do të disbursohen pari pasus nga kontributi financiar i dhënë nga Bashkimi Europian dhe huaja e dhënë në kuadrin e bashkëpunimit financiar gjerman për këto kontrata. Përfshirja e vetëm është konsulenti institucional për Gjirokastrën dhe Fierin, të përmendur sipas nenit II.2.2 në marrëveshjen e veçantë, që do të paguhet vetëm nga kontributi financiar.

Procedura e drejtpërdrejtë e disbursimit (konsulenti)

Pala e autorizuar do t'i dërgojë KfW-së një aplikim tërheqjeje të nënshkruar rregullisht (shihni shtojcën B), që tregon emrin e përfituesit dhe udhëzimet e pagesës (hollësi të plota bankare).

Dokumentet që mbështesin aplikimin e tërheqjes, sipas rastit.

- Kopje e faturës së konsulentit;
- Prova për bazën e rënë dakord në kontratë për llogaritjen e çmimit në rastin e ndryshimit të çmimeve;
- Lista e shpenzimeve për kostot e rimbursueshme që tregojnë datën, përshkrimin, çmimet, normën e shkëmbimit të shpenzimeve, të nënshkruar rregullisht nga konsulenti që deklaron që informacioni i dhënë është i vërtetë dhe i saktë.

Dokumentet

Të gjitha provat origjinale të shpenzimeve që u përkasin faturave duhet të mbahen deri të paktën pesë vjet pas përfundimit të masave financiare dhe duhet të jenë të mundshme për t'u parë në të gjitha kohët për inspektim nga KfW-ja ose palët e treta të udhëzuara nga KfW-ja (p.sh., audituesit) ose do të dërgohen me kërkesë të KfW-ja ose të palët e treta e autorizuara nga KfW-ja.

Procedura e thjeshtuar e disbursimit të drejtpërdrejtë

Pala e autorizuar i dërgon KfW-së një kërkesë tërheqjeje të nënshkruar rregullisht të certifikuar nga konsulenti (shihni shtojcën C), që tregon emrin e përfituesit dhe udhëzimet e pagesës (hollësi të plota bankare) dhe do të bashkëlidhë një kopje të faturës së kontraktorit.

KfW-ja disburson fondet për llogari të palës së autorizuar drejtpërdrejt te kontraktorët e mallrave dhe shërbimeve që duhet të financohen nga KfW-ja.

Siç është rënë dakord në kontratën e konsulencës, konsulenti do t'i japë palës së autorizuar një "certifikatë pagese" që konfirmon se të gjitha parakushtet për disbursim janë përmbushur dhe të gjithë dokumentet e paraqitur (duke përfshirë garancitë) janë në pajtim me kushtet e kontratës dhe rregulloret dhe standardet e KfW-së.

Dokumentet

Të gjitha provat origjinale të shpenzimeve që u përkasin faturave duhet të mbahen deri të paktën pesë vjet pas përfundimit të masave financiare dhe duhet të jenë të mundshme për t'u parë në të gjitha kohët për inspektim nga KfW-ja ose palët e treta të udhëzuara nga KfW-ja (p.sh., audituesit) ose do të dërgohen me kërkesë të KfW-ja ose të palët e treta të autorizuara nga KfW-ja. Këto prova përfshijnë faturat, dokumentet e dërgimit, protokollet e pranimit dhe të gjitha dokumentet përkatëse të nevojshme për të provuar pagesën.

Njoftimet e debisë do të shpërndahen automatikisht te të adresuarit e marrëveshjes së veçantë dhe të palët e tjera të përfshira siç i komunikohet KfW-së nga pala e autorizuar.

Jeni të lutur të kontaktoni punonjësën e KfW-së të përmendur më sipër, nëse keni pyetje në lidhje me procedurën e disbursimit, duke cituar numrin e referencës së KfW-së.

Shtojca

- A) Shembull i një letre që cakton firmatarët e autorizuar
- B) Formular kërkesë tërheqjeje, konsulentët për procedurën e disbursimit të drejtpërdrejtë
- C) Formular kërkesë tërheqjeje, procedura e disbursimit të drejtpërdrejtë të thjeshtuar

SHTOJCA A E ANEKSIT 6

SHEMBULL I NJË LETRE QË CAKTON FIRMATARËT E AUTORIZUAR

Nga: _____

Pala e përfaqësuesit të autorizuar sipas marrëveshjes së huas/financimit/programit

Drejtuar:

KfW Bankengruppe

Attn: L3a4

Postfach 11 11 41

60046 Frankfurt am Main

Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë
marrëveshja e huas/financimit/programit të KfW-së

Emri i programit: Infrastruktura bashkiake I

16 milionë euro – hua

Numri i referencës së KfW-së: 2009 66 523

4,621,500 euro – kontributi financiar (marrëveshja e delegacionit për fondet EU IPF/MW)-

Numri i referencës së KfW-së: 2020 59 988

I nderuar zotëri/zonjë,

Në lidhje me marrëveshjen e huas/financimit/programit për programin e përmendur më sipër, do të donim t'iu informonim që secili nga personat, ekzemplarët e firmave të të cilëve gjenden në këtë letër, është i autorizuar të nënshkruajë kërkesat e tërheqjes në emër të përkatësisht huamarrësit/përfituesit/njësisë së zbatimit të programit ose agjencisë së zbatimit të projektit.

a) Emri:
Funksioni:
Ekzemplari nënshkrimi: _____

b) Emri:
Funksioni:
Ekzemplari
Nënshkrimi _____

c) Emri:
Funksioni:
Ekzemplari nënshkrimi: _____

Të gjitha njoftimet e mëparshme (sipas rastit) që paraqesin nënshkrimet e punonjësve të autorizuar për të nënshkruar kërkesat për tërheqje në bazë të kësaj huaje/kontributi financiar revokohen.

Me respekt,

Firma e përfaqësuesit të autorizuar të marrëveshjes së huas/financimit/programit

Datë

Shënim. Në rastin kur një kërkesë duhet të nënshkruhet nga më shumë se një punonjës, autorizimi duhet ta shprehë këtë qartë. Nëse firmëtarët e autorizuar ndahen në dy grupe dhe kërkohet nënshkrimi i përbashkët, kjo duhet të shprehet, gjithashtu, qartë.

SHTOJCA B E ANEKSIT 6

Nga:

(Adresa e palës së autorizuar)

(datë)

KfW Bankengruppe
TM a
Postfach 11 11 41
60046 Frankfurt am Main
Federal Republic of Germany

Re.: TM a – Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë
Marrëveshja e huas/financimit/programit të KfW-së
Emri i programit: Infrastruktura bashkiake
16 milionë euro – hua
Numri i referencës së KfW-së: 2009 66 523
4,621,500 euro – kontributi financiar (marrëveshja e delegacionit për fondet EU IPF/MW)
Numri i referencës së KfW-së: 2020 59 988

Kërkesë për tërheqje nr.
Procedura e disbursimit të drejtpërdrejtë (konsulenti)

Në pajtim me kontratat e specifikuar më poshtë, kopje të të cilave ne u kemi paraqitur, shërbimet e mëposhtme janë dhënë rregullisht dhe duhet të paguhen:

Zëri* nr.	Kontrata e konsulencës Datë Me	Fatura e konsulentit Nr. Datë	Monedha/Shuma)

* Zëri- Lista e mallrave dhe shërbimeve

Sipas “Listës së mallrave dhe shërbimeve”, shumat e mëposhtme të pagesave që duhet të paguhet nga huaja/kontributi financiar, që ne u kërkojmë të disbursoni si më poshtë:

Monedha/shuma

.....

Përfituesi (emri dhe adresa e shoqërisë)

.....

Nr. i llogarisë:.....IBAN (sipas rastit)

Emri i bankës:.....kodi BIC :

Banka korrespondente:*.....kodi BIC:

Si provë shoqëruese bashkëlidhur është një kopje e faturës përkatëse, sipas rastit, së bashku me prova për bazën e rënë dakord në kontratë për ndryshimin e çmimeve, listën e shpenzimeve për të rimbursueshmet.

Ne presim njoftimet tuaja për debinë për disbursimet e bëra nga ju.

.....

(Nënshkrimi i palës së autorizuar)

* Përveç kësaj, nëse banka e personit që merr pagesën nuk gjendet në vendin e monedhës së pagesës, duhet të jepet emri dhe adresa e korrespondentit të bankës në atë vend. Kërkohej kërkesë e veçantë për çdo monedhë të kërkuar.

SHTOJCA C E ANEKSIT 6

Nga:

.....
(Adresa e palës së autorizuar)

.....
(datë)

KfW Bankengruppe

TM a

Postfach 11 11 41

60046 Frankfurt am Main

Federal Republic of Germany

Lënda.: TM a – Bashkëpunimi Financiar Gjerman me Shqipërinë

Marrëveshja e huas/financimit/programit të KfW-së

Emri i programit: Infrastruktura bashkiake

16 milionë euro – hua

Numri i referencës së KfW-së: 2009 66 523

Kërkesë për tërheqje nr.
Procedura e thjeshtuar e disbursimit të drejtpërdrejtë

Në pajtim me kontratat e specifikuar më poshtë, kopje të të cilave u kemi paraqitur, shërbimet e mëposhtme janë dhënë rregullisht dhe duhet të paguhet:

Zëri* nr.	Kontrata për mallra/shërbime e datës me	Fatura Nr. Datë	Monedha/Shuma)

* Zëri i “Listës së mallrave dhe shërbimeve”

Sipas “Listës së mallrave dhe shërbimeve”, shumat e mëposhtme të pagesave që duhet të paguhet nga huaja/kontributi financiar, që ne u kërkojmë të disbursoni si më poshtë:

Monedha/shuma

.....

Përfituesi (emri dhe adresa e shoqërisë)

.....

Nr i llogarisë:.....IBAN (sipas rastit)

Emri i bankës:.....kodi BIC :

Banka korrespondente*:.....kodi BIC:

Si provë shoqëruese bashkëlidhur është një kopje e faturës përkatëse.

Konsulenti deklaron që ai ka lëshuar një “Certifikatë Pagese” që konfirmon se shërbimet dhe furnizimet e faturuara janë kryer faktikisht, pagesa është bërë e pagueshme dhe të gjitha dokumentet e nevojshme janë paraqitur dhe janë në pajtim me rregulloret/standardet e KfW-së.

.....

(Nënshkrimi i përfaqësuesit të konsulentit)

Ne presim njoftimet tuaja për debinë në lidhje me disbursimet e bëra prej jush.

.....

(Nënshkrimi i palës së autorizuar)

* Përveç kësaj, nëse banka e personit që merr pagesën nuk gjendet në vendin e monedhës së pagesës, duhet të jepet emri dhe adresa e korrespondentit të bankës në atë vend. Kërkohej kërkesë e veçantë për çdo monedhë të kërkuar.

ANEKSI 7
PËRMBAJTJA DHE FORMA E RAPORTIMIT

1. Fier

Treguesit	Njësia	Viti		
		2010	2011	2012
Sektor				
Norma mesatare e lidhjes, kombëtare	%			
Norma mesatare e lidhjes me kanalizimet e centralizuara, kombëtare	%			
Konsumi mesatar i ujit, kombëtare	l/c/d			
Konsumi mesatar i ujit, zona e programit	l/c/d			
Arritjet e Ndërmarrjes së Ujësjetllësit dhe Kanalizimeve UKKO				
a. Kostoja operative në periudhën e raportimit – Uji	lekë			
Kostoja operative në periudhën e raportimit – kanalizimet	lekë			
b. Prodhimi total në periudhën e raportimit	m ³			
c. Kostoja operative/prodhimi total	lekë/m ³			
d. Numri i popullatës i lidhur me sistemit e furnizimit me ujë	%			
e. Humbjet në ujë (të pajustificuara)	%			
f. Koha mesatare e furnizimit, zona urbane	h/d			
g. Numri i lidhjeve me kanalizimet e centralizuara, zona urbane	%			
h. Nr i personelit (uji dhe kanalizimet)	nr.			
i. Nr i konsumatorëve	nr.			
j. Personeli për 1000 konsumatorë	nr.			
k. Nr i klientëve me matës të instaluar	nr.			
l. Shuma e faturuar në periudhën e raportimit, uji	lekë			
m. Shuma e faturuar në periudhën e raportimit, kanalizimet	lekë			
m. Shuma e arkëtuar në periudhën e raportimit, ujë	lekë			
n. Shuma e arkëtuar në periudhën e raportimit, kanalizime	lekë			
o. Efikasiteti i arkëtimeve (faturuar/arkëtuar)	%			

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
I. Tarifat¹⁾ Fier (në lekë/m ³ pa TVSH)							
- Ujë							
Ekonomi shtëpiake							
Institucione							
Biznes							
- Kanalizime							
Ekonomi shtëpiake							
Institucione							
Biznes							
II. Kontribute (në lekë)							
- nga qyteti i Fierit							
- nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit							
III. Mundësi pagese							
- konsumi mesatar për ekonomi shtëpiake prezumohet 90 lcd (në m ³)							
- fatura mesatare e ekonomive shtëpiake për ujin dhe kanalizimet (në Lek përfshirë TVSH)							
- të ardhurat e ekonomive shtëpiake sipas minimumit jetik (INSTAT)							
- raporti i të ardhurave të ekonomive shtëpiake të varfra shpenzuar për ujë dhe kanalizime							

2. Gjyrokstra

Treguesit	Njësia	Viti		
		2010	2011	2012
Sektor				
Norma mesatare e lidhjes, kombëtare	%			
Norma mesatare e lidhjes me kanalizimet e centralizuara, kombëtare	%			
Konsumi mesatar i ujit, kombëtare	l/c/d			
Konsumi mesatar i ujit, zona e programit	l/c/d			
Arritjet e Ndërmarrjes së Ujësjetllësit dhe Kanalizimeve UKKO				
n. Kostoja operative në periudhën e raportimit – Uji				
Kostoja operative në periudhën e raportimit – kanalizimet	lekë			
o. Prodhimi total në periudhën e raportimit	m ³			
p. Kostoja operative/prodhimi total	lekë /m ³			
q. Numri i popullatës i lidhur me sistemit e furnizimit me ujë	%			
r. Humbjet në ujë (të pajustificuara)	%			
s. Koha mesatare e furnizimit, zona urbane	h/d			
t. Numri i lidhjeve me kanalizimet e centralizuara, zona urbane	%			
u. Numri i personelit (uji dhe kanalizimet)	no.			
v. Numri i konsumatorëve	no.			
w. Personeli për 1000 konsumatorë	no.			
x. Numri i klientëve me matës të instaluar	no.			
y. Shuma e faturuar në periudhën e raportimit, uji	lekë			
m. Shuma e faturuar në periudhën e raportimit, kanalizimet	lekë			
z. Shuma e arkëtuar në periudhën e raportimit, ujë	lekë			
n. Shuma e arkëtuar në periudhën e raportimit, kanalizime	lekë			
p. Efikasiteti i arkëtimeve (faturuar/arkëtuar)	%			

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
I. Tarifat¹⁾ Gjyrokstra (në lekë/m ³ pa TVSH)							
- Uji							
Ekonomi shtëpiake							
Institucione							
Biznes							
- Kanalizime							
Ekonomi shtëpiake							
Institucione							
Biznes							
II. Kontribute (në)							
- nga qyteti i Gjyrokstrës							
- nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit							
III. Mundësi pagese							
- konsumi mesatar për ekonomi shtëpiake prezumohet 90 lcd (në m ³)							
- fatura mesatare e ekonomive shtëpiake për ujin dhe kanalizimet (në lekë përfshirë TVSH)							
- të ardhurat e ekonomive shtëpiake sipas minimumit jetik (INSTAT)							
- raporti i të ardhurave të ekonomive shtëpiake të varfra shpenzuar për ujë dhe kanalizime							

3. Lezha

Treguesit	Njësia	Viti		
		2010	2011	2012
Sektor				
Norma mesatare e lidhjes, kombëtare	%			
Norma mesatare e lidhjes me kanalizimet e centralizuara, kombëtare	%			
Konsumi mesatar i ujit, kombëtare	l/c/d			
Konsumi mesatar i ujit, zona e programit	l/c/d			
Arritjet e Ndërmarrjes së Ujësllësit dhe Kanalizimeve UKKO				
aa. Kostoja operative në periudhën e raportimit – Uji	lekë			
Kostoja operative në periudhën e raportimit – kanalizimet	lekë			
bb. Prodhimi total në periudhën e raportimit	lekë/m ³			
cc. Kostoja operative/prodhimi total	lekë/m ³			
dd. Numri i popullatës i lidhur me sistemit e furnizimit me ujë	%			
ee. Humbjet në ujë (të pajustificuara)	%			
ff. Koha mesatare e furnizimit, zona urbane	h/d			
gg. Numri i lidhjeve me kanalizimet e centralizuara, zona urbane	%			
hh. Numri i personelit (uji dhe kanalizimet)	no.			
ii. Numri i konsumatorëve	no.			
jj. Personeli për 1000 konsumatorë	no.			
kk. Numri i klientëve me matës të instaluar	no.			
ll. Shuma e faturuar në periudhën e raportimit, uji	lekë			
m. Shuma e faturuar në periudhën e raportimit, kanalizimet	lekë			
mm. Shuma e arkëtuar në periudhën e raportimit, ujë	lekë			
n. Shuma e arkëtuar në periudhën e raportimit, kanalizime	lekë			
q. Efikasiteti i arkëtimeve (faturuar/arkëtuar)	%			

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
I. Tarifat ¹⁾ Lezha (në lekë/m ³ pa TVSH)							
- Uji							
Ekonomi shtëpiake							
Institucione							
Biznes							
- Kanalizime							
Ekonomi shtëpiake							
Institucione							
Biznes							
II. Kontributet (në)							
- nga qyteti i Lezhës							
- nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit							
III. Mundësi pagese							
- konsumi mesatar për ekonomi shtëpiake prezumohet 90 lcd (në m ³)							
- fatura mesatare e ekonomive shtëpiake për ujin dhe kanalizimet (në lekë përfshirë TVSH)							
- Të ardhurat e ekonomive shtëpiake sipas minimumit jetik (INSTAT)							
- raporti i të ardhurave të ekonomive shtëpiake të varfra shpenzuar për ujë dhe kanalizime							

4. Saranda

Treguesit	Njësia	Viti		
		2010	2011	2012
Sektor				
Norma mesatare e lidhjes, kombëtare	%			
Norma mesatare e lidhjes me kanalizimet e centralizuara, kombëtare	%			
Konsumi mesatar i ujit, kombëtare	l/c/d			
Konsumi mesatar i ujit, zona e programit	l/c/d			
Arritjet e Ndërmarrjes së Ujësllësit dhe Kanalizimeve UKKO				
nn. Kostoja operative në periudhën e raportimit - Uji	lekë			
Kostoja operative në periudhën e raportimit - kanalizimet	lekë			
oo. Prodhimi total në periudhën e raportimit	m ³			
pp. Kostoja operative/prodhimi total	lekë /m ³			
qq. Numri i popullatës i lidhur me sistemet e furnizimit me ujë	%			
rr. Humbjet në ujë (të pajustificuara)	%			
ss. Koha mesatare e furnizimit, zona urbane	h/d			
tt. Numri i lidhjeve me kanalizimet e centralizuara, zona urbane	%			
uu. Numri i personelit (ujë dhe kanalizimet)	no.			
vv. Numri i konsumatorëve	no.			
ww. Personeli për 1000 konsumatorë	no.			
xx. Numri i klientëve me matës të instaluar	no.			
yy. Shuma e faturuar në periudhën e raportimit, uji	lekë			
mm. Shuma e faturuar në periudhën e raportimit, kanalizimet	lekë			
zz. Shuma e arkëtuar në periudhën e raportimit, ujë	lekë			
n. Shuma e arkëtuar në periudhën e raportimit, kanalizime	lekë			
r. Efikasiteti i arkëtimeve (faturuar/arkëtuar)	%			

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
I. Tarifat¹⁾ Saranda (në lekë /m ³ pa TVSH)							
- Uji							
Ekonomi shtëpiake							
Institucione							
Biznes							
- Kanalizime							
Ekonomi shtëpiake							
Institucione							
Biznes							
II. Kontribute (në lekë)							
- nga qyteti i Sarandës							
- nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit							
III. Mundësi pagese							
- konsumi mesatar për ekonomi shtëpiake presumohet 90 lcd (në m ³)							
- fatura mesatare e ekonomive shtëpiake për ujin dhe kanalizimet (në lekë përfshirë TVSHT)							
- Të ardhurat e ekonomive shtëpiake sipas minimumit jetik (INSTAT)							
- raporti i të ardhurave të ekonomive shtëpiake të varfra shpenzuar për ujë dhe kanalizime							

LIGJ
Nr.10 414, datë 7.4.2011

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, DHE KFW FRANKFURT AM MAIN PËR FINANCIMIN E PROGRAMIT “INFRASTRUKTURA BASHKIAKE I”, SISTEMI I FURNIZIMIT ME UJË DHE KANALIZIME PËR QYTETET LEZHË, GJIROKASTËR, SARANDË DHE FIER”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e programit “Infrastruktura bashkiake I”, sistemi i furnizimit me ujë dhe kanalizime për qytetet Lezhë, Gjirokastrë, Sarandë dhe Fier”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6980, datë 20.4.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE HUAJE
NDËRMJET KFW, FRANKFURT AM MAIN (KFW) DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, TIRANË (HUAMARRËSI)
PËR 16,000,000 EURO
- PROGRAMI I INFRASTRUKTURËS BASHKIAKE I
- FURNIZIMI ME UJË DHE KANALIZIMET PËR QYTETET E LEZHËS, GJIROKASTRËS,
SARANDËS DHE FIERIT

Preambulë

Baza për këtë marrëveshje huaje është marrëveshja që duhet të lidhet ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë mbi bashkëpunimin financiar (FC) (marrëveshja qeveritare).

Me kushtin që Republika Federale e Gjermanisë të japë subvencionet për normat e interesit dhe që Republika Federale e Gjermanisë të japë një garanci për huan, KfW-ja do të japë huan në pajtim me termat dhe kushtet e kësaj marrëveshjeje huaje. Termat dhe kushtet e huas përputhen me kërkesat e OECD-së të zbatueshme në datën e nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje huaje për njohjen si asistencë zyrtare për zhvillimin (ODA).

1. Huaja

1.1 Shuma. KfW-ja do t'i japë Huamarrësit një hua që nuk kalon një total prej 16,000,000 euro (huaja).

1.2 Qëllimi i huas. Huamarrësi e kanalizon huan plotësisht te shoqëritë e shërbimit UK Lezha, UK Gjirokastra, UK Saranda dhe UK Fier (së bashku "Agjencitë e zbatimit të projektit", secila "Agjenci e zbatimit të projektit") në pajtim me kushtet e parashikuara në nenin 2. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit vepron si njësi e zbatimit të programit (njësia e zbatimit të programit) për konsulentin e zbatimit. Huamarrësi merr masa që secila agjenci e zbatimit të projektit të përdorë huan vetëm për të financuar investimet për përmirësimin e sistemeve të furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve në qytetet e Lezhës, Gjirokastrës, Sarandës dhe Fierit, përkatësisht (programi) dhe kryesisht të paguajnë koston e këmbimit valutor dhe që njësia e zbatimit të programit të përdorë huan përjashtimisht për të financuar koston e konsultimit të zbatimit. Njësia e zbatimit të programit, agjencitë e zbatimit të programit dhe KfW-ja do të përcaktojë hollësitë e programit, si dhe mallrat dhe shërbimet që duhet të financohen nga huaja në një marrëveshje të veçantë që duhet të miratohet nga Huamarrësi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave.

1.3 Tatimet, detyrimet, detyrimet doganore. Tatimet dhe detyrimet e tjera publike që duhet të shlyhen nga Huamarrësi, njësia e zbatimit të programit dhe një prej agjencive të zbatimit të projektit, si dhe detyrimet doganore nuk mund të financohen nga huaja.

2. Kanalizimi i huas tek agjencitë e zbatimit të projektit

2.1 Marrëveshja e veçantë e huas. Nëse nuk bihet dakord ndryshe sipas një politike të re të Qeverisë së Shqipërisë, Huamarrësi e kanalizon huan e përcaktuar në euro tek agjencitë e zbatimit të projektit sipas marrëveshjeve të veçanta të huas për një afat prej 40 vjetësh duke përfshirë një periudhë pa shlyerje principali prej 10 vjetësh. Interesi nuk kalon shumën e përgjithshme të interesit që rrjedh nga neni 5.1.

2.2 Përkthimi i certifikuar. Para disbursimit të parë nga huaja, Huamarrësi i dërgon KfW-së një përkthim të certifikuar në anglisht ose gjermanisht për secilën prej marrëveshjeve të huas të specifikuar në nenin 2.1.

2.3 Mosekzistenca e detyrimit për agjencinë e zbatimit të projektit. Kanalizimi i huas nuk përbën detyrim për ndonjë agjenci të zbatimit të projektit kundrejt KfW-së për detyrime e pagesës sipas kësaj marrëveshjeje huaje.

3. Disbursimi

3.1 Kërkesa për disbursim. Menjëherë sapo të përmbushen kushtet paraprake për disbursimin sipas nenit 3.3, KfW-ja disburson huan në pajtim me përparimin e programit me kërkesën e Huamarrësit. Disbursimi realizohet në pajtim me grafikun e disbursimit që gjendet në aneksin 1 të kësaj marrëveshjeje huaje. KfW-ja bën disbursime deri në shumat maksimale të përcaktuara për çdo gjashtë muaj. Në masën që Huamarrësi kërkon disbursime për shumën më të vogël brenda një periudhe prej gjashtë muajsh, shumat e padisbursuara mund të kërkohen në çdo periudhë gjashtëmujore pasuese. Me përjashtim të disbursimit të fundit, KfW-ja nuk është e detyruar të kryejë disbursime në një shumë më të vogël se 1 000 000 euro.

3.2 Afati i fundit për kërkimin e disbursimeve. KfW-ja mund të refuzojë disbursimet pas datës 15/12/2015.

3.3 Kushtet paraprake të disbursimit. KfW-ja është e detyruar të bëjë disbursime të çdo shume sipas kësaj marrëveshjeje huaje vetëm me përmbushjen e kushteve të mëposhtme paraprake në një formë dhe përmbajtje të pranueshme për KfW-në:

a) Huamarrësi ka demonstruar duke paraqitur një opinion ligjor thelbësisht sipas formës së parashikuar në aneksin 2 dhe duke paraqitur kopje të vërtetuara (secila me një përkthim në anglisht ose gjermanisht) të të gjithë dokumenteve të cilave u referohet ky opinion ligjor; që:

aa) Huamarrësi ka përmbushur të gjitha kërkesat sipas së drejtës së tij kushtetuese dhe dispozitave ligjore të tjera për përmbushjen e vlefshme të të gjitha detyrimeve të tij sipas kësaj marrëveshjeje huaje; dhe

bb) KfW-ja është e përjashtuar nga të gjitha tatimet mbi të ardhurat nga interesi, detyrimet dhe tarifrat dhe kosto të ngjashme në Shqipëri për dhënien e huas;

b) Janë paraqitur nënshkrimet ekzemplare të përmendura në nenin 13.1 (përfaqësimi i Huamarrësit);

c) Garancia nga Republika Federale e Gjermanisë e përmendur në nenin 8 është në fuqi pa asnjë kufizim;

d) Huamarrësi ka paguar tarifën e menaxhimit të përmendur në nenin 4.2;

e) Nuk ka ndodhur dhe nuk mendohet të ndodhë ndonjë shkak për zgjidhje; dhe

f) Nuk kanë ndodhur rrethana të jashtëzakonshme që përjashtojnë ose rrezikojnë zbatimin, operimin ose qëllimin e programit, ose përmbushjen e detyrimeve të pagesës të marra përsipër nga Huamarrësi sipas kësaj marrëveshjeje huaje.

Para disbursimit nga huaja, KfW-ja ka të drejtën të kërkojë ato dokumente dhe prova të tjera që i konsideron të nevojshme.

3.4 Marrëveshja e veçantë dhe marrëveshje e veçantë e huas. Në një marrëveshje të veçantë që duhet të miratohet nga Huamarrësi, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, njësia e zbatimit të programit, agjencitë e zbatimit të projektit dhe KfW-ja, do të specifikojë procedurën e disbursimit, duke përfshirë kushtet paraprake specifike për disbursimin dhe veçanërisht provat që duhet të jepen nga njësia e zbatimit të programit dhe/ose agjencitë e zbatimit të projektit, që provojnë se shumat e kërkuara të huas përdoren për qëllimin e parashikuar në këtë marrëveshje huaje. Agjencitë e zbatimit të projektit do të kenë demonstruar duke paraqitur të gjitha dokumentet e kërkuara që kërkesat e përcaktuara në marrëveshjen e veçantë (marrëveshjet e veçanta të zbatimit) janë përmbushur.

3.5 Heqja dorë nga disbursimi. Në pajtim me përmbushjen e detyrimeve të tij ose të detyrimeve të agjencive të zbatimit të projektit, përkatësisht sipas nenit 11, Huamarrësi mund të heqë dorë nga disbursimi i shumave të padisbursuara të huas me pëlqimin e KfW-së në këmbim të pagesës së kompensimit të mospranimit në pajtim me nenin 3.6.

3.6 Kompensimi i mospranimit. Nëse Huamarrësi heq dorë nga disbursimi i një shume huaje, ose nëse një shumë huaje nuk disbursohet fare ose nuk disbursohet brenda afatit të përcaktuar në nenin 3.2 për shkaqe të tjera për të cilat KfW-ja nuk mund të bëhet përgjegjëse, Huamarrësi, jo më vonë se 10 ditë¹ pune nga kërkesa e parë, i paguan KfW-së me kërkesë atë shumë që është normalisht e arsyeshme për të kompensuar KfW-në për çdo humbje, shpenzim ose kosto të pësuar nga KfW-ja si rezultat i mospranimit të shumës së huas në fjalë. KfW-ja llogarit shumën e kompensimit të mospranimit dhe ia komunikon atë Huamarrësit.

4. Tarifat

4.1 Tarifa e përkushtimit. Huamarrësi paguan një tarifë të pakthyeshme përkushtimi prej 0.25% p.a. për shumat e padisbursuara të huas. Tarifa e përkushtimit llogaritet për periudhën që fillon me kalimin e periudhës tremujore pas nënshkrimit të marrëveshjes së huas dhe vazhdon deri në atë datë kur huaja është disbursuar plotësisht, ose anuluar plotësisht, sipas rastit.

Tarifa e përkushtimit është e kërkueshme për pagesë dy herë në vit dhe në shuma të prapambetura më 30 qershor dhe 30 dhjetor të çdo viti (secila “datë pagese”). Për herë të parë është e kërkueshme për t’u paguar më 30 qershor 2011, por jo më parë se data e pagesës pas së cilës kjo marrëveshje huaje hyn në fuqi në pajtim me nenin 14.11.

4.2 Tarifa e menaxhimit. Huamarrësi i paguan KfW-së një tarifë të përgjithshme, të njëhershme dhe të pakthyeshme menaxhimi të barabartë me 1.0% të shumës kryesore të huas së caktuar në nenin 1.1, jo më vonë se pas kalimit të periudhës tremujore pasi kjo marrëveshje huaje të jetë nënshkruar nga KfW-ja ose me kalimin e një periudhe njëmujore pasi kjo marrëveshje huaje të ketë hyrë në fuqi (në varësi se cila është data e mëvonshme), por në çdo rast para disbursimit të parë nga huaja.

5. Interesi

Huamarrësi i paguan KfW-së interes me një normë që përcaktohet si më poshtë:

¹ Ditë pune përkufizohet si një ditë (e ndryshme nga e shtuna ose e diela), në të cilën bankat tregtare janë të hapura për punë të përgjithshme në Frankfurt mbi Main, Gjermani.

5.1 Interesi (norma fikse e interesit e caktuar mbi dhënien e huas). Huamarrësi paguan normë interesi mbi huan me një normë prej 2.2% p.a. (normë fikse interesi) deri në marrjen e kështit të fundit të shlyerjes sipas grafikut të shlyerjes sipas përcaktimit në nenin 6.1.

5.2 Llogaritja e interesit dhe datat e pagesës së interesit. Interesi për një shumë të disbursuar të huas do të ngarkohet nga data (duke përjashtuar) në të cilën shuma përkatëse e huas paguhet nga llogaria e huas që mbahet te KfW-ja për Huamarrësin deri në datën (duke e përfshirë), në të cilën shlyerjet përkatëse kreditohen në llogarinë e KfW-së të përcaktuar në nenin 7.3. Interesi llogaritet në pajtim me nenin 7.1 (llogaritja). Interesi paguhet në shuma të prapambetura në datat e pagesave (sipas përcaktimit në nenin 3.1).

6. Shlyerja dhe parapagimi

6.1 Grafiku i shlyerjes. Huamarrësi e shlyen huan si më poshtë:

Kësti	Datë		Shuma	
1	qershor 30	2014	666.000,00	euro
2	dhjetor 30	2014	666.000,00	euro
3	qershor 30	2015	666.000,00	euro
4	dhjetor 30	2015	666.000,00	euro
5	qershor 30	2016	666.000,00	euro
6	dhjetor 30	2016	666.000,00	euro
7	qershor 30	2017	666.000,00	euro
8	dhjetor 30	2017	666.000,00	euro
9	qershor 30	2018	667.000,00	euro
10	dhjetor 30	2018	667.000,00	euro
11	qershor 30	2019	667.000,00	euro
12	dhjetor 30	2019	667.000,00	euro
13	qershor 30	2020	667.000,00	euro
14	dhjetor 30	2020	667.000,00	euro
15	qershor 30	2021	667.000,00	euro
16	dhjetor 30	2021	667.000,00	euro
17	qershor 30	2022	667.000,00	euro
18	dhjetor 30	2022	667.000,00	euro
19	qershor 30	2023	667.000,00	euro
20	dhjetor 30	2023	667.000,00	euro
21	qershor 30	2024	667.000,00	euro
22	dhjetor 30	2024	667.000,00	euro
23	qershor 30	2025	667.000,00	euro
24	dhjetor 30	2025	667.000,00	euro

6.2 Shumat e padisbursuara të huas. Shumat e padisbursuara të huas do të kompensohen kundrejt kështit përkatës të fundit të shlyerjes në pajtim me grafikun e shlyerjes, përveç kur KfW-ja, sipas diskrecionit të saj, vendos një alternativë tjetër kompensimi në raste të veçanta para njoftimit paraprak të Huamarrësit.

6.3 Disbursimet pas fillimit të shlyerjes. Nëse shumat e huas disbursohen pasi të ketë filluar shlyerja, grafiku i shlyerjes sipas renditjes në nenin 6.1 mbetet e paprekur për sa kohë që kësti përkatës i shlyerjes i kërkueshëm në pajtim me grafikun e shlyerjes është më i vogël se shumat e huas tashmë të disbursuara. Nëse kësti i shlyerjes i kërkueshëm për pagesa e kalon shumën e pakthyer të huas, KfW-ja zbrit shumën e barabartë me diferencën nga kësti i kërkueshëm i shlyerjes, e pjesëton atë me mbetësin e kësteve të shlyerjes të pakthyer dhe ia shton këtë shumë secilit kësht të pakthyer të shlyerjes. KfW-ja rezervon të drejtën të shtyjë marrjen në shqyrtim të disbursimeve që bëhen brenda 45 ditëve para datës përkatëse të pagesës për përcaktimin e shumës së pakthyer të huas deri në datën e dytë të pagesës pas disbursimit.

6.4 Parapagimi. Sa më poshtë zbatohet për shlyerjet e parakohshme:

a) E drejta për të bërë parapagesa. Huamarrësi, në pajtim me nënparagrafët (b) deri (e) më poshtë, mund të bëjë një pagesë të parakohshme në lidhje me një shumë huaje, me kusht që kjo pagesë e parakohshme të jetë të paktën në shumën e një kësti shlyerjeje në pajtim me nenin 6.1.

b) Njoftimi. Një parapagim i një shume huaje në pajtim me nenin 6.4 a) i nënshtrohet një njoftimi parapagimi nga Huamarrësi drejtuar KfW-së jo më vonë se dita bankare e pesëmbëdhjetë (sipas përcaktimit në nenin 14.1) në Frankfurt mbi Main para datës së përcaktuar të parapagimit. Ky njoftim është i parevokueshëm; ai duhet të përcaktojë datën në të cilën do të bëhet parapagimi dhe shuma e tij që detyron Huamarrësin t'i paguajë KfW-së shumën e përcaktuar në datën e caktuar.

c) Kompensimi i parapagimit. Nëse Huamarrësi parapaguan një shumë huaje me një normë fikse interesi, Huamarrësi, brenda 10 ditëve pune, i paguan KfW-së me kërkesë atë shumë që është normalisht e nevojshme për të kompensuar çdo humbje, shpenzim ose kosto që i është shkaktuar KfW-së si rezultat i parapagimit. KfW-ja përcakton shumën e kompensimit të parapagimit dhe ia komunikon atë Huamarrësit.

d) Shumat e kërkueshme. Huamarrësi paguan gjithashtu shumat e mëposhtme së bashku me parapagesën në pajtim me nenin 6.4 a) deri c):

aa) çdo kompensim parapagese të kërkueshëm si rezultat i parapagimit në pajtim me nenin 6.4 c); dhe

bb) të gjithë interesin e mbledhur mbi shumën e parapaguar të huas deri në datën e parapagimit.

e) Kompensimi. Neni 6.2 (shumat e padisbursuara të huas) zbatohet mutatis mutandis për kompensimin e parapagimeve.

6.5 Grafiku i rishikuar i shlyerjeve. Në rastin kur zbatohet neni 6.3 (disbursimet pas fillimit të shlyerjes) ose neni 6.4 (parapagimi), KfW-ja i dërgon Huamarrësit një grafik të rishikuar shlyerjeje që bëhet pjesë integrale e kësaj marrëveshjeje huaje dhe zëvendëson grafikun e shlyerjes të vlefshëm deri në atë kohë.

7. Llogaritjet dhe pagesat në përgjithësi

7.1 Llogaritja. Interesi, tarifa e përkushtimit, interesvonesa në pajtim me nenin 7.5, kompensimi i plotë për shumat e prapambetura në pajtim me nenin 7.6, kompensimi i papranueshëm dhe kompensimi i parapagimit do të llogariten mbi bazën e një viti me 360 ditë me muaj me 30 ditë.

7.2 Data e kërkueshme. Nëse një pagesë që bëhet në lidhje me këtë marrëveshje huaje bëhet e kërkueshme në një datë që nuk është ditë bankare (sipas përcaktimit në nenin 14.1) Huamarrësi duhet ta bëjë këtë pagesë në ditën bankare pasuese. Nëse dita pasuese bankare bie në muajin kalendarik pasues, pagesa përkatëse bëhet në ditën e fundit bankare të muajit kalendarik aktual të asaj kohe.

7.3 Numri i llogarisë, koha e kreditimit. Huamarrësi lirohet nga detyrimet e tij të pagesës në lidhje me këtë marrëveshje huaje nëse dhe menjëherë sapo shumat përkatëse t'i jenë kredituar KfW-së në disponim të saj të lirë pa asnjë zbritje në euro dhe jo më vonë se ora 10:00 paradite në Frankfurt mbi Main në llogarinë e KfW-së /IBAN DE23 5002 0400 0312 5608 01 që mbahet nga KfW-ja, Frankfurt mbi Main, me referencë shtesë në datën e kërkueshme (ref. VVVVMMDD")

7.4 Kundërpretendimet e Huamarrësit. Huamarrësi nuk ka të drejtë të ngrejë asnjë pretendim mbajtjeje ose kompensimi apo të drejta të ngjashme ndaj detyrimeve për pagesa sipas kësaj marrëveshjeje huaje, përveç kur këto të drejta njihen me vendim përfundimtar dhe nuk kundërshtohen nga KfW-ja.

7.5 Interesvonesa. Nëse një këst shlyerjeje ose një parapagesë, në pajtim me nenin 6.4 (parapagimi), nuk janë në dispozicion të KfW-së kur bëhen të kërkueshme, KfW-ja, pa paralajmërim, mund të ngarkojë interes me një normë prej 300 pikë bazë p.a. mbi normën bazë për periudhën që fillon në datën e kërkueshme dhe që mbaron në datën në të cilën këto pagesa kreditohen në llogarinë e KfW-së të specifikuar në nenin 7.3. Kjo normë duhet të paktën të jetë e barabartë me normën e interesit të huas. "Norma bazë" është norma e interesit e njoftuar nga Banka Qendrore Gjermane (Deutsche Bundesbank) si norma bazë që mbizotëron në datën përkatëse të kërkueshme. Ky interes i munguar bëhet menjëherë i kërkueshëm pas kërkesës së parë të KfW-së dhe duhet të paguhet brenda 10 ditëve pune.

7.6 Kompensimi me shumë të plotë. Për shumat e prapambetura (me përjashtim të atyre kësteve të shlyerjeve dhe parapagesave të përmendura në nenin 7.5 (interesvonesa) KfW-ja, pa paralajmërim, mund të kërkojë kompensim me shumë të plotë me një normë prej 300 pikë bazë p.a.

mbi normën bazë të zbatueshme në datën përkatëse të kërkueshme për periudhën që fillon në datën e kërkueshme dhe që mbaron në datën e pagesës së këtyre shumave të prapambetura. Kompensimi me shumë të plotë bëhet menjëherë i kërkueshëm pas kërkesës së parë të KfW-së dhe duhet të paguhet brenda 10 ditëve pune. Huamarrësi është i lirë të provojë që faktikisht nuk është shkaktuar asnjë dëm ose që dëmet nuk janë shkaktuar në shumën e përcaktuar.

7.7 Kompensimi. KfW-ja ka të drejtën të kompensojë pagesat e marra kundrejt pagesave të kërkueshme sipas kësaj marrëveshjeje huaje ose sipas marrëveshjeve të tjera të huas të lidhura ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit. Në këtë rast, Huamarrësi do të informohet menjëherë nga KfW-ja.

7.8 Llogaritë e bëra nga KfW-ja. Në mungesë të gabimeve të dukshme në përcaktimet e KfW-së dhe llogaritjen e shumave sipas kësaj marrëveshjeje huaje dhe në lidhje me këtë marrëveshje huaje përbëjnë provë *prima facie*.

8. Garancia nga Republika Federale Gjermane

KfW-ja do të marrë garanci nga Republika Federale Gjermane për pretendimet e pagesave sipas kësaj marrëveshjeje huaje para disbursimit të parë.

9. Pengu negativ dhe *pari passu*

9.1 Ndalimi i pengut ose hipotekës. Huamarrësi merr masat që asetet e programit të mos rëndohen me peng ose hipotekë dhe as të tjetërsohen para shlyerjes së plotë të huas dhe që asnjë marrëveshje ose masë tjetër nuk ndërmerret nëse efekti i saj është krijimi i një garancie ose të drejte që jep prioritet pagese në lidhje me një detyrim të një personi, pa pëlqimin paraprak të KfW-së.

9.2 *Pari passu*. Në masën që lejohet nga ligji, Huamarrësi merr përsipër të përmbushë detyrimet sipas kësaj marrëveshjeje huaje *pari passu* me të gjitha detyrimet e saj ekzistuese ose të ardhme për pagesë, të pasiguruara dhe të pavarura.

10. Kostoja dhe detyrimet publike

10.1 Ndalimi i zbritjeve ose mbajtjeve. Huamarrësi bën të gjitha pagesat sipas kësaj marrëveshjeje huaje pa asnjë zbritje për tatimet, detyrimet e tjera publike ose kosto të tjera. Në rastin që Huamarrësi është i detyruar me ligj ose shkaqe të tjera të bëjë zbritje ose ndalesa të tilla mbi pagesat, Huamarrësi paguan çdo shumë të tillë të nevojshme shtesë për KfW-në, në mënyrë që shuma neto që mbetet pas çdo ndalese ose zbritjeje të përputhet me shumën që do të ishte e pagueshme sipas kësaj marrëveshjeje huaje nëse nuk do të ishin bërë këto zbritje ose ndalesa.

10.2 Kostot. Huamarrësi mbulon të gjitha shpenzimet dhe kostot që shkaktohen në lidhje me disbursimin e huas, veçanërisht koston e dërgimit dhe transferimit (duke përfshirë tarifën e konvertimit), si dhe të gjitha kostot dhe shpenzimet që shkaktohen në lidhje me mbajtjen ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje huaje.

10.3 Tatimet dhe detyrimet e tjera. Huamarrësi mbulon të gjitha tatimet dhe detyrimet e tjera publike që shkaktohen jashtë Republikës Federale Gjermane mbi lidhjen dhe nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje huaje.

10.4 Kostot e shtuara. Nëse për shkak të:

a) përmbushjes së kërkesave të lëshuara nga banka qendrore ose një autoritet tjetër fiskal, monetar ose tjetër pas datës së kësaj marrëveshjeje huaje;

ose

b) një ndryshimi në ligj ose interpretimin dhe administrimin e tij;

ose

c) hyrjes në fuqi, zgjidhjes ose ndryshimit të një marrëveshjeje ose traktati të zbatueshëm bilateral ose multilateral, veçanërisht mbi tatimin e dyfishtë;

KfW-ja pëson kosto ose humbje shtesë ose nuk është në gjendje të marrë marzhin e rënë dakord mbi koston e saj të rifinancimit si rezultat i lidhjes dhe financimit të kësaj marrëveshjeje huaje (kosto të shtuara), KfW-ja njofton për këtë Huamarrësin. Çdo kërkesë e tillë nga KfW-ja shoqërohet me një njoftim nga KfW-ja që deklaron shkakun për këtë kërkesë dhe përcakton me hollësi të arsyeshme llogaritjen e shumës përkatëse. Huamarrësi zhdëmton menjëherë KfW-në me kërkesë për të gjitha kostot e shtuara. Neni 6 zbatohet *mutatis mutandis*.

11. Detyrime të veçanta

11.1 Zbatimi i programit dhe informacioni i veçantë. Huamarrësi, i përfaqësuar nga njësi e zbatimit të programit:

a) Detyron agjencitë e zbatimit të projektit për të përgatitur, zbatuar, operuar dhe mbajtur nën-projektet në pajtim me praktikën e qëndrueshme financiare dhe teknike dhe thelbësisht në pajtim me konceptin e programit të rënë dakord ndërmjet njësive të zbatimit të programit, agjencive të zbatimit të projektit dhe KfW-së;

b) U ngarkon përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të nën-projekteve inxhinierëve konsulentë ose konsulentëve të kualifikuar dhe të pavarur;

c) Siguron që agjencitë e zbatimit të projektit të japin kontratat për mallrat dhe shërbimet që financohen nga huaja me ofertim paraprak konkurrues ndërkombëtar;

d) Siguron financimin e plotë të programit dhe i jep KfW-së me kërkesë të saj prova që provojnë se kostoja që nuk paguhet nga kjo hua është mbuluar;

e) Detyron agjencitë e zbatimit të projektit të mbajnë libra dhe regjistra që tregojnë qartësisht koston e të gjitha mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për programin dhe identifikon qartësisht mallrat dhe shërbimet e financuara nga huaja;

f) Siguron që agjencitë e zbatimit të projektit ndjekin hapat e zbatimit të programit për përmirësimet e monitoruara nga afër të punës, sipas përcaktimit në marrëveshjen e veçantë (marrëveshjet e veçanta të zbatimit). Çdo informacion i tillë duhet t'i jepet nga agjencitë e zbatimit të projektit huamarrësit dhe KfW-së.

g) Merr masa që përfaqësuesit e KfW-së të kenë mundësi në çdo kohë të inspektojnë librat dhe regjistrat dhe çdo dokumentacion tjetër në lidhje me zbatimin dhe operimin e programit, dhe për të vizituar programin dhe të gjitha instalimet në lidhje me të;

h) I jep KfW-së dhe merr masa që çdo informacion dhe regjistër i tillë mbi programin dhe progresin e tij të mëtejshëm t'i jepet KfW-së sipas kërkesës së KfW-së;

i) Menjëherë dhe me iniciativë të vet:

aa) merr masa që agjencitë e zbatimit të projektit i japin KfW-së çdo pyetje të marrë nga agjencitë e zbatimit të projektit nga OECD-ja ose anëtarët e tij sipas së ashtuquajturës "Marrëveshje për transparencën e kredive ODA të bashkuara" pas dhënies së kontratave për furnizimet dhe shërbimet që do të financohen nga huaja dhe bashkërendon përgjigjet e këtyre pyetjeve me KfW-në; dhe

bb) njofton KfW-në për çdo rrethanë që përjashton ose rrezikon seriozisht zbatimin, operimin dhe qëllimin e programit.

11.2 Marrëveshja e veçantë. Huamarrësi, i përfaqësuar nga njësi e zbatimit të programit, agjencitë e zbatimit të projektit dhe KfW-ja përcakton hollësitë e nenit 11.1 me marrëveshje të veçantë.

11.3 Respektimi. Huamarrësi siguron që personat të cilëve ai u beson përgatitjen dhe zbatimin e Programit, dhënien e kontratës për furnizimet dhe shërbimet që do të financohen, dhe kërkimin e shumave të huas nuk kërkojnë, pranojnë, bëjnë, japin, premtojnë apo pranojnë premtimin e pagesave të paligjshme ose avantazhe të tjera në lidhje me këto detyra.

11.4 Transporti i mallrave. Dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen qeveritare do të zbatohen për transportin e mallrave që financohen nga huaja.

12. Zgjidhja

12.1 Rastet e mosplotësimit të detyrimeve. KfW-ja mund të ushtrojë të drejtat e parashikuara në nenin 12.2 (pasojat ligjore të një rasti të mosplotësimit të detyrimeve) nëse një ngjarje ndodh dhe përbën shkak të rëndësishëm (*wichtiger Grund*). Veçanërisht, ngjarjet e mëposhtme përbëjnë shkak të rëndësishëm:

a) Huamarrësi ose Garantuesi nuk përmbush detyrimet ndaj KfW-së për të bërë pagesat kur bëhen të kërkueshme;

b) Detyrimet sipas kësaj marrëveshjeje huaje ose sipas marrëveshjeve të veçanta që i përkasin kësaj marrëveshjeje huaje janë shkelur;

c) Kjo marrëveshje huaje ose çdo pjesë e saj pushon së pasuri efekt detyrues mbi Huamarrësin ose pushon së qeni e ekzekutueshme ndaj Huamarrësit;

d) Një deklaratë, konfirmim, informacion ose përfaqësim ose garanci e konsideruar nga KfW-ja thelbësore për dhënien dhe mbajtjen e huas del false, e gabuar ose e paplotë;

e) Ndodhin rrethana të tjera të jashtëzakonshme që vonojnë ose përjashtojnë përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj marrëveshjeje huaje; ose

f) Huamarrësi ose një agjenci e zbatimit të projektit nuk është në gjendje të provojë që shumat e huas janë përdorur për qëllimin e parashikuar;

g) Një nga ngjarjet e mëposhtme ka ndodhur në lidhje me Huamarrësin:

aa) Huamarrësi nuk është në gjendje të paguajë borxhet kur bëhen të kërkueshme;

bb) fillimi i bisedimeve me një ose më shumë kreditorë të Huamarrësit (me përjashtim të KfW-së) mbi heqjen dorë nga borxhet e prapambetura ose për një moratorium apo zgjidhjeje.

12.2 Pasojat ligjore të rasteve të mosplotësimit të detyrimeve. Nëse një prej ngjarjeve të përmendura në nenin 12.1 ka ndodhur dhe nuk është eliminuar brenda një periudhe prej pesë ditësh (në rastin e nenit 12.1 a) ose, në të gjitha rastet e tjera të specifikuar në nenin 12.1, nuk është zgjidhur brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja që nuk mund të jetë më pak se 30 ditë, KfW-ja mund të zgjidhë këtë marrëveshje huaje ose çdo pjesë të saj me pasojën që:

a) Detyrimet e saj sipas kësaj marrëveshjeje huaje pushojnë; dhe

b) KfW-ja mund të kërkojë shlyerjen e plotë ose të pjesshme të shumës së prapambetur të huas së bashku me interesin e mbledhur dhe të gjitha shumat e tjera të kërkueshme sipas kësaj marrëveshjeje huaje. Neni 7.5 (interesi i munguar) dhe 7.6 (kompensimi me shumë të plotë) zbatohet mutatis mutandis për shumat e përshpejtuara.

12.3 Kompensimi për dëmet. Në rastin kur huaja zgjidhet plotësisht ose pjesërisht para se të jetë shlyer plotësisht, huamarrësi do të paguajë kompensimin e mospranimit në pajtim me klauzolën 3.6 (kompensimi i mospranimit) dhe/ose kompensimin e parapagimit në pajtim me klauzolën 6.4 (kompensimi i parapagimit).

13. Përfaqësimi dhe deklaratimet

13.1 Përfaqësimi i Huamarrësit. Ministri i Financave dhe ata persona që caktohen prej tij ose saj për KfW-në dhe autorizohen nëpërmjet ekzemplarëve të nënshkrimeve të vërtetuara prej tij ose saj përfaqësojnë Huamarrësin në zbatimin e marrëveshjes së huas. Fuqia e përfaqësimit nuk skadon nëse revokimi shprehimisht prej përfaqësuesit të Huamarrësit të autorizuar në atë kohë, nuk merret prej KfW-së.

13.2 Adresat. Njoftimet ose deklaratimet në lidhje me këtë marrëveshje huaje duhet të jenë me shkrim. Ato duhet të dërgohen në origjinale ose – me përjashtim të kërkesave për disbursime – me faks. Të gjitha njoftimet dhe deklaratimet e tjera të bëra në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje duhet të dërgohen në adresat e mëposhtme:

Për KfW-në: KfW
L3A4
Postfach 11 11 41
60046 Frankfurt am Main / Germany
Germany
Fax: +49 69 7431-2547

Për Huamarrësin: Ministria e Financave
Bulevardi: “Dëshmorët e Kombit” nr.1
Al-Tirana
Faks (+355)-4-222 8494

14. Dispozita të përgjithshme

14.1 Dita bankare. Nëse bëhet referencë në këtë marrëveshje huaje te një “ditë bankare”, kjo do të thotë një ditë e ndryshme nga e shtuna ose e diela në të cilën bankat tregtare në Frankfurt mbi Main janë të hapura për punë të përgjithshme.

14.2 Vendi i përmbushjes. Vendi i përmbushjes së të gjitha detyrimeve sipas kësaj marrëveshjeje huaje është Frankfurt mbi Main, Republika Federale Gjermane.

14.3 Pavlefshmëria e pjesshme dhe boshllëqet. Nëse një dispozitë e kësaj marrëveshjeje huaje është ose bëhet e pavlefshme, ose ka një boshllëk në një prej dispozitave të kësaj marrëveshjeje huaje, kjo nuk ndikon në vlefshmërinë e dispozitave të tjera të saj. Palët në këtë marrëveshje huaje zëvendësojnë çdo dispozitë të pavlefshme me një të vlefshme ligjërishit që është sa më afër që është e mundur me frymën dhe qëllimin e dispozitës së pavlefshme. Palët mbushin çdo boshllëk në dispozitat me një dispozitë ligjërishit të vlefshme që është sa më afër që është e mundur me frymën dhe qëllimin e kësaj marrëveshjeje huaje.

14.4 Forma dhe ndryshimi me shkrim. Ndryshimet dhe shtesat në këtë kontratë duhet të bëhen me shkrim. Çdo heqje dorë nga kjo kërkesë me formë me shkrim duhet të deklarohet nga palët me shkrim.

14.5 Transferimi. As Huamarrësi, as njësia e zbatimit të programit nuk mund të transferojnë, rëndojnë me peng ose hipotekë çdo pretendim nga kjo marrëveshje huaje.

14.6 Ligji i zbatueshëm. Kjo marrëveshje huaje rregullohet nga ligjet e Republikës Federale të Gjermanisë.

14.7 Periudha e parashkrimit. Të gjitha pretendimet e KfW-së sipas kësaj marrëveshjeje huaje parashkruhen pas pesë vjetësh nga fundi i vitit në të cilën ky pretendim ka lindur dhe në të cilën KfW-ja ka marrë dijeni për rrethanat që përbëjnë këtë pretendim ose mund të kishte ardhur në dijeni të tyre pa neglizhencë të theksuar.

14.8 Heqja dorë nga imuniteti.

a) Në masën që Huamarrësi tashmë ose në të ardhmen në çdo juridiksion pretendon për vete ose sendet e tij imunitet nga padia, ekzekutimi, sekuestroja ose një masë tjetër ligjore dhe në masën që në një juridiksion të tillë ky imunitet mund t'i jepet vetes së tij ose sendeve të tij, Huamarrësi bie dakord në mënyrë të parevokueshme për të mos pretenduar dhe heq dorë në mënyrë të parevokueshme nga ky imunitet në masën më të gjerë të mundshme të lejuar nga ligjet e këtij juridiksioni.

b) Në çdo rast, Huamarrësi nuk heq dorë nga asnjë imunitet, në lidhje me ekzekutimin për:

(i) "Ambientet e misionit" të tashme ose të ardhshme të përkufizuara në Konventën e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike të vitit 1961, "ambientet konsullore" të tashme ose të ardhshme të përkufizuara në Konventën e Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore të nënshkruar në vitin 1963 ose që përdoret ndryshe nga një diplomat ose mision diplomatik i Shqipërisë ose një agjenci ose instrument i saj;

(ii) Një pasuri të paluajtshme që rregullohet nga dispozitat e nenit 3, paragrafi 1-3 i ligjit shqiptar nr.8743, të datës 22/02/2001 "Mbi pasurinë e paluajtshme shtetërore";

(iii) Çdo fond monetar dhe/ose shumë që është bërë e kërkueshme dhe është paguar në momentin e ekzekutimit për përmbushjen e detyrimeve që Republika e Shqipërisë ka sipas traktateve, konventave dhe/ose marrëveshjeve ndërkombëtare të së drejtës publike të nënshkruar prej saj.

14.9 Mosmarrëveshjet ligjore

Arbitrazhi. Të gjitha mosmarrëveshjet që rrjedhin nga ose në lidhje me këtë marrëveshje huaje do të zgjidhen vetëm dhe përfundimisht nga një gjykatë arbitrazhi. Në lidhje me këtë, zbatohet sa më poshtë:

a) Gjykata e arbitrazhit përbëhet nga një ose tre arbitra që emërohen dhe veprojnë në pajtim me rregullat e arbitrazhit të dhomës ndërkombëtare të tregtisë (ICC) të ndryshuara herë pas here.

b) Gjykimi në arbitrazh zhvillohet në Frankfurt mbi Main. Gjykimi zhvillohet në gjuhën angleze.

14.10 Transmetimi i informacionit. KfW-ja ka të drejtë t'i transmetojë lëshuesit të garancisë federale të përmendur në nenin 8 dhe Republikës Federale Gjermane informacion në lidhje me përfundimin dhe nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje huaje. KfW-ja, lëshuesi i garancisë federale dhe Republika Federale Gjermane kanë të drejtë të kalojnë informacionin në lidhje me huan dhe Programin, duke përfshirë dhënien e kontratave për furnizimet dhe shërbimet që financohen nga

huaja organizatave ndërkombëtare të përfshira në mbledhjen e të dhënave statistikore, veçanërisht në lidhje me çështjet për shërbimin e borxhit dhe/ose mbledhjen dhe publikimin e të dhënave në lidhje me dhënien e kontratave për furnizimet dhe shërbimet që financohen nga Huaja. E drejta e mësipërme për dhënien e informacionit organizatave ndërkombëtare përfshin edhe të drejtën për të kaluar drejtpërdrejt këtë informacion anëtarëve të këtyre organizatave.

14.11 Hyrja në fuqi. Kjo marrëveshje huaje dhe programi nuk hyn në fuqi derisa marrëveshja qeveritare mbi të cilën ajo bazohet të ketë hyrë në fuqi dhe Huamarrësi të ketë informuar KfW-në me shkrim që marrëveshja e programit dhe huas është ratifikuar dhe ratifikimi i saj është publikuar rregullisht.

Kjo marrëveshje huaje nënshkruhet në 2 kopje origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt mbi Main, Tiranë,

KfW

Republika e Shqipërisë

ANEKSI 1

Në fund të çdo periudhe të treguar më poshtë, Huamarrësi do të ketë kërkuar disbursimin e shumave të huas që nuk kalojnë në total shumën e treguar më poshtë për secilën periudhë (të gjitha shifrat në euro).

	Disbursuar në periudhën e tashme	Disbursuar në periudhën e mëparshme	Disbursimi i plotë
02/2010	0	0	0
01/2011	300.000	0	300.000
02/2011	1.700.000	300.000	2.000.000
01/2012	2.700.000	2.000.000	4.700.000
02/2012	3.600.000	4.700.000	8.300.000
01/2013	3.000.000	8.300.000	11.300.000
02/2013	2.700.000	11.300.000	14.000.000
01/2014	1.000.000	14.000.000	15.000.000
02/2014	350.000	15.000.000	15.350.000
01/2015	300.000	15.350.000	15.650.000
02/2015	350.000	15.650.000	16.000.000

ANEKSI 2

Shënim. Jeni të lutur të ndryshoni si duhet “Republika e VENDI” / “VENDI”.

MODEL I OPINIONIT LIGJOR TË KËSHILLTARIT LIGJOR PËR HUAMARRËSIN (SHTETI)

[Koka e letrës së këshilltarit ligjor]

KfW

(datë)

Departamenti []

Në vëmendje të: []

Palmengartenstrasse 5 - 9

Postfach 11 11 41

60325 Frankfurt am Main / Germany

Republika Federale Gjermane

Marrëveshje e huas e datës dhe e lidhur ndërmjet KfW-së (.....) (Huamarrësi) dhe (.....) për një shumë që nuk kalon në total ___ 000 000 euro.

Të nderuar zotërinj,

Unë jam (Ministri i Drejtësisë) (këshilltar ligjor i) (shef i departamentit ligjor) . . . (jeni të lutur të specifikoni ministrinë ose autoritetin tjetër) të Republikës së VENDI. Unë kam vepruar në këtë cilësi në lidhje me marrëveshjen e huas (marrëveshja e huas), datë, të bërë ndërmjet Huamarrësit (. . . .) dhe jush në lidhje me një hua që do t'i jepet prej jush Huamarrësit në një shumë që nuk kalon në total _____000.000 euro.

1. Dokumentet e shqyrtuara

Unë kam shqyrtuar:

1.1 një kopje të nënshkruar autentike të marrëveshjes së huas;

1.2 dokumentet kushtetuese të Huamarrësit, veçanërisht:

a) Kushtetutën e Republikës së VENDI, datë , të publikuar rregullisht në , nr. , faqe. , e ndryshuar;

b) Ligji(et) nr datë , të publikuar/a rregullisht në , nr. , faqe. , e ndryshuar; (jeni të lutur të fusni, nëse ka, ligje (p.sh., ligjet e buxhetit) në lidhje me marrjen hua të parave nga Republika e VENDI);

c) [jeni të lutur t'u referoheni këtu dokumenteve të tjerë, p.sh., dekreteve ose rezolutave të organeve qeveritare ose administrative të VENDIT mbi lidhjen e marrëveshjeve të huave nga VENDI në përgjithësi ose mbi lidhjen e marrëveshjes së huas); dhe

d) Marrëveshja e bashkëpunimit financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së VENDIT dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë të datës (marrëveshja e bashkëpunimit);

dhe ato ligje, rregullore, certifikata, regjistra, të dhëna dhe dokumente dhe janë bërë ato hetime të tjera që unë i kam çmuar të nevojshme ose të dëshirueshme për qëllimin e dhënies së këtij mendimi.

2. Mendim

Për qëllimet e nenit të marrëveshjes së huas, unë jam i mendimit që sipas ligjeve të Republikës së VENDIT të kësaj date:

2.1 Në pajtim me nenin të Kushtetutës / nenit të ligjit nr (jeni të lutur të specifikoni sipas rastit) Huamarrësi ka të drejtë të lidhë marrëveshjen e huas dhe ka marrë të gjitha veprimet e nevojshme për të autorizuar nënshkrimin, dhënien dhe përmbushjen e marrëveshjes së huas, veçanërisht në bazë të:

a) Ligjit(ve) nr datë të parlamentit të Republikës së VENDIT, që ratifikon marrëveshjen e huas / aprovon nënshkrimin, dhënien dhe përmbushjen e marrëveshjes së huas nga Huamarrësi / (jeni të lutur të përfshini sipas rastit);

b) Rezoluta(t) nr datë të Kabinetit të Ministrave / të komitetit të huave shtetërore / (jeni të lutur të përfshini organet qeveritare ose administrative të VENDIT sipas rastit);

(c) (jeni të lutur të përfshini rezoluta, vendime të tjera etj.).

2.2 Znj/Z. (dhe Znj/Z.) është (janë) të autorizuar rregullisht nga (p.sh., ligji në sajë të pozicionit të tij/saj (si Ministër i / si), nga rezoluta qeveritare. , me prokurë të datës etj.) të nënshkruaj vetëm/bashkërisht marrëveshjen e huas në emër të Huamarrësit. Marrëveshja e huas e nënshkruar nga Znj/Z. (dhe Znj/Z.) është nënshkruar rregullisht nga ana e Huamarrësit dhe përbën një detyrim ligjërisht detyrues për Huamarrësin të ekzekutueshëm ndaj tij ligjërisht në pajtim me termat e saj.

(Alternativa 1 për seksionin 2.3, që përdoret nëse përveç dokumenteve të specifikuar në Seksionin 2.1 dhe 2.2 duhet të merren autorizime të caktuara zyrtare sipas ligjeve të Republikës së VENDIT).

2.3 Për nënshkrimin dhe përmbushjen e marrëveshjes së huas nga huamarrësi (duke përfshirë pa kufizim marrjen dhe transferimin te KfW-ja të të gjitha shumave të kërkueshme në bazë të saj në monedhat e specifikuar në të), janë marrë aprovimet, autorizimet, licencat, regjistrimet dhe/ose pëlqime e mëposhtme zyrtare dhe janë në fuqi të plotë:

(a) Aprovimi i (Banka Qendrore/Banka Kombëtare/.], datë, nr.;

b) Pëlqimi i [Ministri / Ministria e], datë, nr.; dhe

c). (jeni të lutur të rendisni çdo autorizim, licencë dhe/ose pëlqim tjetër zyrtar).

Asnjë autorizim, pëlqim, licencë, regjistrim dhe/ose aprovim tjetër zyrtar i një autoriteti ose agjencie qeveritare (duke përfshirë Bankën Qendrore/Zyrtare të Republikës së VENDIT) ose gjykate nuk kërkohet apo është e këshillueshme në lidhje me nënshkrimin dhe përmbushjen e marrëveshjes së huas nga Huamarrësi (duke përfshirë pa kufizim marrjen dhe transferimin te KfW-ja të të gjitha shumave që kërkohen në monedhat e specifikuar atje) dhe vlefshmëria dhe ekzekutueshmëria e detyrimeve të Huamarrësit sipas marrëveshjes së huas.

(Alternativa 2 për seksionin 2.3, që përdoret vetëm nëse përveç dokumenteve të specifikuar në seksionin 2.1 dhe 2.2 asnjë autorizim zyrtar nuk duhet të merret sipas ligjeve të Republikës së VENDIT).

2.3 Asnjë autorizim, pëlqim, licencë, regjistrim dhe/ose aprovim tjetër zyrtar i një autoriteti ose agjencie qeveritare (duke përfshirë Bankën Qendrore/Zyrtare të Republikës së VENDIT) ose gjykate nuk kërkohet apo është i këshillueshëm në lidhje me nënshkrimin dhe përmbushjen e marrëveshjes së huas nga Huamarrësi (duke përfshirë pa kufizim marrjen dhe transferimin te KfW-ja të të gjitha shumave që kërkohen në monedhat e specifikuar atje) dhe vlefshmëria dhe ekzekutueshmëria e detyrimeve të Huamarrësit sipas marrëveshjes së huas.

2.4 Asnjë tatim vule ose tatim apo detyrim i ngjashëm nuk duhet të paguhet në lidhje me vlefshmërinë ose ekzekutueshmërinë e marrëveshjes së huas.

2.5 Zgjedhja e ligjit gjerman për të rregulluar marrëveshjen e huas dhe paraqitjen për arbitrazh në pajtim me nenin 14.9 të marrëveshjes së huas janë të vlefshme dhe detyruese. Vendimet e arbitrazhit kundër Huamarrësit njihen dhe janë të ekzekutueshëm në Republikën e VENDIT në pajtim me rregullat e mëposhtme: (jeni të lutur të përfshini traktatin e zbatueshëm (sipas rastit) p.sh., Konventën e Nju-Jorkut të vitit 1958, dhe/ose parimet bazë në lidhje me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit në VEND).

2.6 Gjykatat e Republikës së VENDIT kanë drejtën të japin vendime të përcaktuara në monedhën ose monedhat e specifikuar në marrëveshjen e huas.

2.7 Huamarrja nga Huamarrësi sipas marrëveshjes së huas, si dhe nënshkrimi dhe përmbushja e marrëveshjes së huas nga Huamarrësi përbëjnë akte private dhe tregtare dhe jo akte publike ose qeveritare. As Huamarrësi dhe asnjë prej sendeve të tij nuk ka të drejtë imuniteti nga arbitrazhi, padia, përmbarimi, sekuestrimi ose veprime të tjera ligjore. Megjithatë, Huamarrësi nuk ka hequr dorë nga imuniteti, në lidhje me përmbarimin për:

- “Ambientet e misionit” të tashme ose të ardhshme të përkufizuara në Konventën e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike në vitin 1961, “ambientet konsullore” të tashme ose të ardhshme të përkufizuara në Konventën e Vjenës mbi marrëdhëniet konsullore të nënshkruar në vitin 1963 ose që përdoret ndryshe nga një diplomat ose mision diplomatik i Shqipërisë ose një agjenci ose instrument i saj;

- Një pasuri të paluajtshme që rregullohet nga dispozitat e nenit 3, paragrafi 1-3 i ligjit shqiptar nr.8743, të datës 22/02/2001 “Mbi pasurinë e paluajtshme shtetërore”;

- Çdo fond monetar dhe/ose shumë që është bërë e kërkueshme dhe është paguar në momentin e ekzekutimit për përmbushjen e detyrimeve që Republika e Shqipërisë ka sipas traktateve, konventave dhe/ose marrëveshjeve ndërkombëtare të së drejtës publike të nënshkruar prej saj.

2.8 Marrëveshja e bashkëpunimit është në fuqi të plotë sipas kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së VENDIT (në pajtim me nenin 3 të marrëveshjes së bashkëpunimit) (nëse marrëveshja e bashkëpunimit nuk ka hyrë në fuqi por ekziston një marrëveshje e tatimit të dyfishtë). Në pajtim me(jeni të lutur të specifikoni traktatin ose ligjet e zbatueshme dhe rregulloret), Huamarrësit nuk i kërkohet të bëjë asnjë zbritje ose ndalesë nga pagesa që Huamarrësi duhet të bëjë sipas marrëveshjes së huas dhe nëse një zbritje apo ndalesë duhet të vendoset më vonë, dispozitat e nenit 10.1 të marrëveshjes së huas zbatohen për t'i kërkuar Huamarrësit të zhdëmtojë përkatësisht KfW-në.

2.9 KfW-ja nuk është dhe nuk konsiderohet të jetë rezidente, me seli apo të zhvillojë biznes apo t'i nënshtrohet tatimit në Republikën e VENDIT thjesht për shkak të nënshkrimit, përmbushjes ose ekzekutimit të marrëveshjes së huas. Nuk është e nevojshme apo e këshillueshme që KfW-ja të licencohet, kualifikohet apo të marrë të drejtë në mënyrë tjetër për të zhvilluar biznes ose që KfW-ja të emërojë agjentë apo përfaqësues në Republikën e VENDIT.

Për pasojë, detyrimet e Huamarrësit sipas marrëveshjes së huas përbëjnë detyrime të drejtpërdrejta dhe pa kusht, të ligjshme, të vlefshme dhe detyruese për Huamarrësin dhe janë të ekzekutueshme ndaj Huamarrësit në pajtim me termat e tyre përkatëse.

Ky mendim ligjor kufizohet për ligjet e Republikës së VENDIT.

.....,
(vendi) (data)

[Nënshkrimi]

Emri:

Bashkëlidhur:

Shënim. Jeni të lutur të bashkëlidhni fotokopje të certifikuara të dokumenteve dhe dispozita ligjore të përmendura më sipër në seksionin 1.2 (a) deri 1.2(c) dhe seksionet 2.1 deri 2.3 dhe 2.8 (në lidhje me ligjet e gjata dhe Kushtetutën e Republikës së VENDIT, një kopje e dispozitave përkatëse duhet të jetë e mjaftueshme) dhe t'i japë KfW-së një përkthim të certifikuar në anglisht ose gjermanisht të secilës prej dokumenteve të sipërpërmendura nëse këto dokumente nuk janë lëshuar në anglisht ose gjermanisht si një gjuhë zyrtare.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 26.4.2011
Doli nga shtypi më 28.4.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 40 lekë